



PROFETI
Muhammed (a.s.)
MODELI QË I DUHET NJERËZIMIT



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 05 (468)
Maj, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.



PËRMBAJTJA

4 Profeti Muhamed (a.s.), Modeli që i duhet njerëzimit / Redaksia

6 Shëndeti mendor dhe roli i fesë / Mehmet Disha

8 Lajme / Aktivitete



12 Një burrë, një grua në zemër të modernitetit / Tark Ramadan

16 Kuptimi i jetës / Prof. Dr. Ayhan Tekines

18 Nepotizmi në administratë dhe Hz. Ijad Ibn Ganm (r.a.) / Taulant Bica

22 Kiameti, exheli i universit / Blerim Lazimi

24 Hatixhja (r.a.), modeli i gruas myslimane / Nadia Lika

28 Vërat e zeza në organizimin Islam / Prof.dr.sc. Edin Tule



30 Hafiz Mustafa Doraci (1894-1972) / Xhemal Balla

32 Xhamia Selimie / Ali Fevziu

34 Pesha e fjalës / Aisa Kokiçi

36 Shërimi me erëzat / Erion Sukaj

38 E shkuara e mëpastajme e dhelprës dinake / Hysen Kobellari



PROFETI Muhammed (a.s.) MODELI QË I DUHET NJERËZIMIT

Të gjithë bashkohen se ai është njeriu që la më shumë mbresë dhe ndikim në historinë njerëzore. Mbi të gjitha një njeri i madh, një profet i denjë, një prijës sypatrembur, një diplomat i zoti, një komunikues i shkëlqyer, një paqebërës i vendosur, një falës i devotshëm, një baba shembullor, një bashkëshort i dashur!

Janë vetëm disa cilësi që, parë me pasqyrën e shekullit të XXI-të, janë të gjitha cilësitë që i kërkojnë një njeriu të suksesshëm sot... sa arrijmë t'i bëjmë ne të gjitha këto (kuptohet përveç profetësisë që ishte e drejtë që Zoti ia dha vetëm atij), kjo është çështja. Askush të mos thotë se vlerat që ai la pas janë mbuluar nga mjegulla e kohës dhe pluhuri i harresës. Ende sot njerëzit kanë nevojë për njerëz besnikë, apo "Emin" siç atë e thërrisnin rrugëve të Mekës, Medines, Jeruzalemit e Damaskut...

Njerëzit duan paqen e jo më luftën! Dhe ai ishte paqebërësi më i madh... ai shkoi në luftë vetëm kur u sulmua! Ai nuk sulmoi, shau, denigroi, apo përfoli dikë. Ai shtriu dorën për myslimanë, të krishterë, hebrenj dhe madje edhe për jobesimtarë! Ky ishte misioni i tij, PAQJA, mision i cili na bie ne myslimanëve nga një copë si detyrë që ai na e ka lënë.

Njerëzit duan që të jetojnë me trimat... dhe ai ishte i tillë! Por nuk ishte hakmarrës e jo i rrëmbyer si një lumë në vjeshtë. Ai ishte trim sepse mbi të gjitha dinte të ruante rrëmbimin e inatit dhe hasmërisë! Ishte ai që e mësoi Aliun se armiku luftohet për hir të Zotit dhe jo për hir të robit... dhe Aliu uli shpatën kur armiku përballë e pështyu... "të luftoj për Zotin, i tha e jo për veten time..."

Njerëzit duan të kenë të bëjnë me diplomatë

të shkëlqyer që me asnjë komb të mos kenë probleme! Dhe ai ishte një kryediplomat që edhe mbreti i krishterë Nexhashiu e priti me besim. Është ai modeli që i duhet diplomacisë botërore për të sheshuar luftën që ka plasur në Shtëpinë e Ibrahimit...

Njerëzit duan të kenë përballë e të jenë komunikues të shkëlqyer... dhe ai ishte i tillë! Zëri i tij, syri i tij, dora e tij dhe argumenti i tij, zbutën zemra burrash të ashpër që kishin shkuar për ta vlarë... Ai është modeli i komunikimit që njerëzimi kërkon!

Njerëzit kanë nevojë për falje, të mos ndëshkohen për ato që bënë me hir a me pahir... dhe ai ishte falës i madh! Ai besonte se kush fal në këtë botë, i Gjithëmëshirshmi do ta falë në botën tjetër për ato që bëri keq mbi dhé. Ai është modeli i zemërbutësisë dhe sakrificës që edhe vrasësin e komandantit të parë mysliman, Hamzait, dashuria e Allahut qoftë mbi të, e fali...

Njerëzit duan të kenë prindër të mirë e të dashur dhe bashkëshortë idealë... ai ishte i tillë dhe dëshmitarë janë të afërmit dhe pasuesit e tij!

Ai është, o lexues durimtar i këtyre rreshtave, modeli që njerëzimi ka pasur nevojë, ai është modeli që vetë ne myslimanët ende nuk e kemi kuptuar, ai është modeli që të tjerët e kanë keqkuptuar, ai është modeli që ende ka popuj në botë që nuk e njohin... Ai është modeli që mund ta nxjerrë këtë botë nga bataku i luftës, xhelozisë, pabesisë dhe dredhivë.

Ai është Muhamedi (a.s.)! Paqja dhe bekimi i Allahut, qofshin mbi Të, familjen dhe gjithë pasuesit e tij që nga dita e parë e profetësisë e deri sot!





SHËNDETI MENDOR DHE
roli i fesë

Dihet tashmë se në vendin tonë, nuk ka një plan të mirëfilltë për funksionimin e trajtimit të shëndetit mendor, as për mirëqenien sociale të shtetasve, madje as nuk është në fokus fakti se si varfëria po i bren njerëzit me ankth, stres e depresion të niveleve të ndryshme, nga pamundësia për të përballuar jetesën.

Fakti që njeriu i kësaj kohe ndihet tmerrësisht i vetmuar, i pambrojtur, i paorientuar, i zbrazët në zemër dhe i prirur për të mos qenë në dijeni të një arsyeje madhore që ka ekzistenca e tij në këtë univers, si edhe, fakti që rutina e jetës bashkëkohore, filmat, muzika, librat, rrjetet sociale dhe modeli i të kapurit pas materiales, dhe përditshmëria e padobishme për trupin, mendjen, shpirtin dhe zemrën njerëzore, janë larg urtësisë së Hyjnore dhe mosmbajtja e përgjegjësisë, shkakton trauma dhe trandje të mëdha në ndërgjegjet njerëzore. Kur themi "mosmbajtja e përgjegjësisë", nënkuptojmë mosvlerësimin që njerëzit kanë ndaj përjetimeve, jetës dhe ndaj ekzistencës, duke pandehur se janë të lirë të bëjnë ç'të duan, e se nuk do të kenë ndikime nga veprimet, punët apo fjalët e thëna. Duke i shtuar kësaj edhe pandeminë e Covid-19 që kaluam, luftën mes Ukrainës dhe Rusisë që bën jehonë dhe që rriti pothuajse në çdo sferë çmimet e gjithçkaje e madje shtoi frikërat për jetën në planet, si edhe duke shtuar edhe faktin që korrupsioni në gjithë këto vite ua ka prerë shpresat shqiptarëve për ëndrrat e tyre dhe për të ardhmen, mendoj se njeriu i kësaj epoke, sidomos në vendin tonë, ka nevojë për mbështetje të domosdoshme.

Zoti në Kur'an i ka bërë të qarta disa kufij, në mënyrë që njeriu të mos i tejkalojë ato, e madje të mos u afrohet. Shpesh njerëzit e keqkuptojnë rëndësinë e ndalesave nga Krijuesi, pasi e shohin njeriun si një qenie njëdimensionale, pra si një qenie fizike e materiale e ngerthyer veç në dimensionin e kësaj bote, ndërkohë që Zoti, në suren Isra, thotë: "Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto do të merren në përgjegjësi." (Kur'an, 17:36) Këtu ne kuptojmë se njeriu ndërvepron me botën si një qenie që ka trup, shpirt e mendje dhe këto duhen të jenë në harmoni, duke shkuar pas asaj që është e shpallur me dituri nga ana e Krijuesit i cili e njeh më së miri krijimin e Tij.

Kështu, kohët bashkëkohore, kanë sjellë modele të panumërta jetesash që janë të dëmshme për mendjen, shpirtin e zemrën. Fryhet në zgjerim uni, egoja dhe epshi, te të mëdhenjtë e të vegjlit, si dhe tkurret zemra, ndërgjegjja e shpirti dhe krejt barrën e bart trupi. Kur njeriu s'gjen orientim, mekanizmat e fuqishme që ai ngërthen në vete, revoltohen të kaplojnë frerët e drejtimit dhe kjo është fatale. Këtu po mjaftohemi shkurtimisht për të mos u zgjatur në detaje, të cilat, me lejen e Zotit, mbeten për t'u lëvruar në një shkrim tjetër.

Si imam dhe si njohës i situatës, them se na janë mbushur xhamitë me njerëz që vijnë e kërkojnë ndihmë për shqetësime të brendshme, ngaqë nuk dinë ku të drejtohen, dhe ndërkohë, sigurisht, në të personelit të xhamive jemi

"mjekë" të shpirtërores apo të shqetësimeve që lidhen me zemrën dhe me anën metafizike të njeriut, dhe nga ana tjetër, ndonëse kemi dijeni, nuk kemi njohuri të thelluara që nevojiten për ndërhyrje dhe për diagnostifikime në raport me shëndetin mendor.

Profeti Muhamed a.s. kishte dituri tepër të thelluara për të gjitha disiplinat, që ia mësoi i Gjithëdituri dhe i Gjithëurti Krijues, por ne, nuk i kemi përvetësuar të gjitha ato që ai na la pas, në nivel mjeshtëror, sepse janë dimensione që një njeri s'mund t'i ngërthejë lehtë, kjo dëshmon se Muhamedi ishte profet ngase pati në vetvete dimensione që i tejkalonin horizontet tona, këto janë në librat përkatës, të gjithë mund t'i lexojnë, këto i patën pothuajse të gjithë profetët.

Dua të them, sot duhet bashkëpunim me ekspertë të fushës së shëndetit. Kur shprehemi se na janë mbushur xhamitë, është pak, sepse sharlatanët që yshtin e fryjnë në Shqipëri e kanë radhën pafund, i shihni në emisionet hetuese, dhe i gjeni në lajmërimi që ata vënë rrugëve e në rrjete sociale, duke u tallur me njerëzit që kanë shqetësime e brenga, në këmbim të parave, ndërkohë spitalet shtetërore janë thuar pa personel dhe spitalet private i kanë tarifat e konsultave tepër të larta.

Këtu duhet ndërhyrja e ekspertëve të shëndetit (disiplinës shkencore) dhe të besimeve fetare (disiplinës shpirtërore).

Ne e lidhim gjithçka me fenë e besimin sepse mendojmë se përherë kjo ka qenë e do mbetet arsyeja kryesore e shkundjes së qenies njerëzore: pa besimin në Zot, pa u ruajtur nga ndalesat, pa ndjekur rregullat e fesë që Zoti ka zbritur në tokë, njeriu është i rrënuar në të dyja rrafshet, në atë fizik dhe në atë metafizik.

E them këtu me plot bindje nga qindra eksperiencia se me anë të Kur'anit dhe lutjeve profetike, deri më tani, kam qenë dëshmitar se leximi i këtyre praktikave fetare janë bërë shkak që Zoti të japë shërim disa pacientëve që vuanin nga ankthe të ndryshme, dridhje të trupit, mpirje, mendime lodhëse dhe insomniake, çrregullime në të sjellur, paraliza dhe ngërçe në pjesë të ndryshme lokale apo tërësore të trupit, mangësi në të folur te fëmijët, zënka dhe zemërim të paarsyshme dhe spontane që shfaqen te njerëzit, mangësi në të menduar dhe përhumbje etj. Këto janë pak, nuk po futem në detaje, sepse sigurisht ky proces lipset të ndiqet në bashkëpunim edhe me disiplinat shkencore të dhura, në mënyrë që rastet e rënduara të marrin trajtim si duhet. Të gjitha këto, janë mësim të Profetit Muhamed a.s, i cili nuk e kundërshtoi kurrë mjekësinë e asokohshme që ishte e pranishme me aq dije sa qenë mbledhur nga përvojat njerëzore, ai veç sa pastroi besëtytninë e kësaj fushe dhe i përftoi mjekësinë dimensionin metafizik, duke e plotësuar, duke bërë kështu atë që sot shkenca e psikologjisë përipiqet të bëjë. Profeti Muhamed a.s. e la derën hapur për shkencën, madje i dha guxim e forcë duke pohuar se nuk ka sëmundje në tokë që Zoti të mos i ketë sjellë asaj shërim. Pra, kërkojeni e gjejeni!

Lus Zotin të na lehtësojë barrën e kësaj epoke, të na mbajë të fortë në besim, të na japë shërim dhe të na ndriçojë me dritën e udhëzimit të Tij!



1

KOMUNITETI MYSLIMAN SHTRON IFTARIN E PARË TË MUAJIT TË RAMAZANIT

Në iftarin e parë të shtruar nga Komuniteti Mysliman, morën pjesë besimtarë të shumtë, personalitete të shoqërisë civile, gazetarë, politikanë, ndër ta, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Veliaj, Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, z. Taulant Balla, ministret Spiropali dhe Muzhaqi. Ishin të pranishëm gjithashtu diplomatë të vendeve të ndryshme mike.

Iftari i parë, natën e parë të Ramazanit, është prej vitesh një traditë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Mbrëmë ishte një rikthim pas ndërprerjes për shkak të pandemisë covid-19.

Kryetari i KMSH, nën kujdesin e të cilit u shtrua edhe Iftari, mbajti edhe një fjalë të shkurtër për të pranishmit.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, ndër të tjera, shtoi: "Lutja është për të gjithë agjëruesit për herë të parë dhe për ata që janë një hap larg këtij adhurimi. Ju inkurajoj të provoni shijen e pakrahasueshme të këtij adhurimi. Agjërimi do t'ju ndryshojë jetën dhe këndvështrimin për të. I lutem Zotit që bota të gjejë sa më shumë paqe e qetësi. I lutem Zotit ta begatojë vendin dhe popullin tonë."

2

25 TON HURMA DHURATË NGA MBRETI I ARABISË SAUDITE

Me rastin e muajit të bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpërnda 25 ton hurma arabie për besimtarët dhe agjëruesit dhuratë nga mbreti i Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz, për popullin shqiptar, e sjellë në vendin tonë nga Qendra Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndihma Humanitare.

Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë z. Bujar Spahiu, kryetar i KMSH, z. Faisal Ghazi Hifdhi, ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë dhe Abdulmexhid el-Kahtani, përfaqësues i qendrës bamirëse në fjalë.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, kryetari Spahiu falënderoi bamirësit me në krye mbretin Selman bin Abdulaziz për këtë dhuratë të vyer dhe ambasadën e Arabisë Saudite në vendin tonë për koordinimin, si dhe i siguroi të gjitha palët për angazhimin maksimal të KMSH-së në bashkëpunime si ky me mbretërinë e Arabisë Saudite dhe ambasadën e saj në vendin tonë.

Ndërsa ambasadori saudit në vendin tonë, z. Hifdhi, u shpreh se nisma si kjo janë shenjë e qartë e solidaritetit dhe dashamirësisë që Mbretëria e Arabisë Saudite ka kundrejt vendeve mike dhe se vendi ynë Shqipëria bën pjesë në krye të këtyre vendeve.

Ngarkesa e plotë e hurmave i është dorëzuar tashmë KMSH-së, e cila po ia shpërndan besimtarëve në mbarë vendin nëpërmjet myftinive të saj nëpër rrethe.





2

VIZITË ZYRTARE NË ARABINË SAUDITE

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu ishte në një vizitë zyrtare në Arabinë Saudite. Vizita vjen në kuadër të ftesës së posaçme nga Ministri i Mbretërisë së Arabisë Saudite për Çështjet Fetare.

Gjatë këtij udhëtimi, Kryetari Spahiu shoqërohej nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, këshilltari i tij, z. Xhemal Seferti dhe myftiu i Gramshit, z. Ermir Gjana.

Pas mbërritjes në Jeddah të Arabisë Saudite, kryetari u prit nga zëvendës ministri i Çështjeve Fetare, z. Auad el-Anezi, i cili shtroi edhe një darkë mikpritëse në nder të kryetarit Spahiu dhe delegacionit që e shoqëron.

Më tej, i shoqëruar nga delegacioni i tij, z. Spahiu kreu edhe ritin e Umres në Qabenë e Sherijë.

Pas qëndrimit në qytetin Jeddah, Kryetari i KMSH, z. Bujar Spahiu, ka vizituar edhe qytetin Medines.

Z. Spahiu u prit nga Drejtori i Degës së Ministrisë për Çështjet Fetare në Arabinë Saudite, dega Medine, z. Uexheb el-Utejbij.

Gjatë qëndrimit të tij në Medine, bashkë me delegacionin shoqërues, kryetari Spahiu do të zhvillojë vizita dhe takime në institucione shtetërore të nivelit të lartë.

Gjatë qëndrimit në Medine, Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, së bashku me delegacionin e tij zhvilloi një vizitë pune pranë Kompleksit të mirënjohur "Mbreti Fehd" për Botimin e Kuranit, ku u prit nga përfaqësues të lartë të kompleksit, me në krye z. Khalid Suleiman el-Nefsi, Sekretar i Përgjithshëm i qendrës në fjalë.

Gjatë takimit kryetari Spahiu i njohu mikpritësit me institucionin e KMSH dhe sfida që ai përballon çdo ditë në përcjelljen e mesazhit të islamit në shoqërinë.





5

FALJA E NAMAZIT TË FITËR BAJRAMIT NË SHESHIN "SKËNDERBEJ"

Mijëra besimtarëmyslimanë, nw datwn 02.05.2022, falën namazin e Fitër Bajramit në sheshin "Skënderbej" në Tiranë dhe mijëra të tjerë në sheshet kryesore të çdo qyteti të vendit.

Programi i Fitër Bajramit filloi që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut në shesh, për të vijuar më pas me këndimin e një pjese nga Kurani Famëlartë, të cilën e përcolli për besimtarët e pranishëm hafizi Besmir Krruta.

Më tej ishte radha e fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli mesazhe të shumta urimi e solidariteti.

"Muaji Ramazan është muaji ku për secilin nga ne u krijuan rrethanat për shpëtim dhe udhëzim në rrugën e vërtetë. Lutemi të kemi dalë nga ky muaj me pastërti dhe ndriçim shpirtëror!" – tha ai.

Më tej Kryetari Spahiu u ndal edhe në rrugëtimin e institucionit, rrugëtim ky i cili vitin e ardhshëm kremton 100-vjetorin e tij.

"Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është në prag të përkujtimit të 100-vjetorit të themelimit dhe pavarësisë së tij. Nuk ka qenë i lehtë rrugëtimi i këtij institucioni. Sfidat dhe peripecitë që kanë kaluar kolosët e islamit në Shqipëri, ndër ta paraardhës të mitë si Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Sabri Koçi, nuk kanë qenë të leta. Por ata ia dolën të ruajnë pavarësinë dhe integritetin e këtij institucioni duke u lidhur fort pas burimeve të pastra, Kuranit dhe Sunnetit të profetit (a.s.). Ne kemi trashëguar nga paraardhësit tanë një frymë tolerance, harmonie dhe vetëvendosje. Ky është një amanet! Ne do ta ruajmë fort atë!" – u shpreh Kryetari Spahiu.

Programi vijoi më tej me fjalën përshëndetëse të Nënkrugarit të KMSH-së, z. Taulant Bica, i cili ndau me mijëra besimtarët e pranishëm mesazhe të shumta paqeje dhe solidariteti.

Më tej u bë falja e namazit të bajramit, ku mijëra besimtarët e mbledhur në shesh i priu Kryetari i Komunitetit, H. Bujar Spahiu, për të vazhduar më pas me hutben e Fitër Bajramit e cila u mbajt nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.





6

DHJETËRA PERSONALITETE UROJNË BESIMTARËT PËR FITËR BAJRAM

Menjëherë pas përfundimit të faljes së Fitër Bajramit në "Sheshin Skënderbej", Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizitat tradicionale me rastin e kësaj feste.

Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë ishin Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, Kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Veliaj, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kulturë, z. Klodian Bulku, krerët e komuniteteve të tjera fetare të vendit, si dhe drejtues të institucioneve shtetërore, lokale, përfaqësues të subjekteve politike, trupit diplomatik në Tiranë, personalitete të jetës publike, të fushës së artit, medias, biznesit, etj.

Në mesazhet e tyre ata shprehën urimet dhe përshëndetjet më të përzemërta për besimtarët myslimanë të cilët me Fitër Bajramin mbyllin kështu maratonën 30-ditore të muajit të bekuar të Ramazanit.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.



Një burrë, një grua NË ZEMËR TË MODERNITETIT

Nëse do të përqendroheshim në botën tonë dhe do ta kuptonim atë, ajo do të na shfaqej gjithnjë e më e izoluar. Ditët kalojnë dhe vërtetojnë gjithnjë e më shumë lajthitjen e njeriut. I sjellë deri këtu nga teknika dhe zhurma, ai ndërton jetën e tij bazuar mbi shpejtësinë, shkencat kompjuterike, muzikën dhe kinemanë.

I tejngarkuar nga uria dhe lodhja, heshtazi ai ngre mbijetesën e vet bazuar mbi pritshmëritë dhe shpresat.

Kohët moderne do të mbartin për kujtimet tona interesin për imazhin dhe neglizhencën e pafundme të realitetit dhe kuptimit.

Në lindje sikundër edhe në perëndim, epoka jonë buron urinë më të tmerrshme që ka ekzistuar ndonjëherë mbi tokë. Trupat e torturuar kumbojnë vuajtjet e mendjeve... trupat dhe zemrat të etura për pak njerëzi. Varfëria, hallakatja, diktatura dhe luftërat, çdo ditë e më shumë i zënë frymën dinjitetit të miliona njerëzve, burra dhe gra, dhe nuk e lejojnë atë të gjejë shprehje lirshëm. Vetmia, individualizmi, mjerimi moral, mungesa e dashurisë ushqehet me qenien e gjithë atyre të cilëve rehatia do të duhej t'u kishte dhuruar edhe kënaqësinë.

Ku është rruga? Ku jemi duke shkuar ne?

Si mund të jesh një burrë... si mund të jesh një grua sot? Gjendur në bërthamën e kësaj agonie, si jemi ne duke iu përgjigjur zemrave tona dhe si jemi duke e mbrojtur dimensionin tonë shpirtëror? Në humnerën e kaq shumë disekuilibrave, si jemi ne duke përçarur atë ekuilibër dhe harmoni që zemrave tona do t'u japë qetësinë?

Si mbetemi ne besimtarë, besnikë ndaj paktit të origjinës, ndërsa modernizmi na kthen në kaq mosbesues ndaj të qenit njeri?

Kujtimi i agimit të parë: "Përkujto kur Zoti yt, nxori nga

shpina e bijve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Unë Zoti juaj?". Ata thanë: "Po, dëshmuam"... (Kur'ani, 7: 172)

Kjo dëshmi jeton në thellësitë e zemrave tona; na flet dhe na bën thirrje. Zemra jonë është shpresa jonë; shpirti ynë është rruga jonë:

"...se në të vërtetë sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në kraharorë..." (Kur'ani, 22:46)

Kjo do të thotë të shohësh në thellësitë e vetvetes, sepse zotëron fuqinë e shikimit, shikimit të vërtetë. Do të thotë të jesh me Zotin tënd duke lexuar shenjat e Tij. Të jetosh me përkujtimin e Tij për të mbushur veten me nënshtrimin ndaj Tij, për t'i dhënë natës dritën e saj dhe për t'u lutur fuqishëm në heshtjen e pafund.

"Ne do të shpallim ty një fjalë të rëndë. E s'ka dyshim se veprimi i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë. Vërtet, ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë. Por ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij. Zoti i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka zot tjetër vetëm Ai, pra Atë merre për mbështetje." (Kur'ani, 73: 5-9)

Është kaq e vështirë t'i japësh jetë zemrës tënde. Vrap i përditshëm i botës na largon nga vetja në atë pikë sa shpesh e thyen më dysh personalitetin tonë duke na grisur në qindra copëra. E kam këtë kujtim kaq të afërt në sytë e mi: një imazh nga Tunizia, Egjipti, India ... pastaj Amerika, Europa... e kam në Lindje sikundër e kam në Perëndim, e kam të premtëve ashtu edhe në të gjithë ditët e tjera të javës: copëtimi i botës islame është aty.

Populli, komuniteti, dëshirat, shpresat dhe qëllimet më të mira. Dita më e bukur e javës, dita e të gjitha simboleve.

Rituali - përkujtim mbi kuptimin, sytë e lagur, lotët e zemrës. Bota islame vlon në këtë fillim të shekullit të njëzetë e një, ashtu sikundër vlonte dikur, në fillim



të shekullit të shtatë. Zoti është dëshmitar për këtë forcë besimi. Xhamitë hapen, rrugët kthehen në xhami, i gjithë globi është një xhami. Umeti është këtu; i pasuri dhe i varfri, shkencëtari kompjuterist dhe analfabeti, dëshmitarë të së njëjtës dëshmi, duke kërkuar të shuajnë të njëjtën etje.

E shtunë, e diel dhe çfarë pason. Pesë orë të mëngjesit, pasdites, apo edhe katër. Gjumi është kaq i rëndë, puna kaq preokupuese. Kaq shumë heshtje të premtëve dhe kaq shumë fjalë në ditët që pasojnë. Kaq shumë vërtetësi dhe pastaj kaq shumë gënjeshtër, kaq shumë shpresa dhe pastaj kaq shumë ankime, kaq shumë dëshirë dhe pastaj kaq shumë apati. Kishte këtu një kujtim, ajo që mbeti është harresa. Kishte kaq shumë këtu, por mbeti kaq pak. Gjatë ditëve të javës, jeta e përditshme gjen justifikimet e saj që kthehen në arsye për besimin tonë. Epoka jonë është një torturë. Dimensionin ynë shpirtëror është sprova jonë.

Të premtëve, sikundër edhe në ditët e tjera të javës, plagët tona janë të thella.

Ka disa të cilët, të shtyrë nga egoizmi i kësaj bote, përshtatin një mënyrë jete mistike. Larg nga bota, ambiciet dhe konfliktet; të ushqyer nga drita e të vetmes Dritë. Në përfundim ka qenë konsideruar se ky ishte "Islami i vërtetë", "Islami tjetër", ai që të imponon respekt, përderisa është një Islam që sulmon mendjet. Dikush

duhet të jetojë larg, që të jetojë më mirë; të braktisë njerëzit në mënyrë që t'i afrohet Zotit më shumë. Epoka Mistikët, me anë të meditimit të tyre, veçimit të tyre të brendshëm, dhe evitimit të botës kanë ndjekur dhe janë duke ndjekur shembullin e Profetit a.s., i cili shpenzonte net të tëra në falje e meditim, duke kthjelluar kujtimin e tij, duke thëlluar mirënjohjen e tij dhe duke perfeksionuar adhurimin ndaj Tij. Lotët e derdhur nga meditimi bëjnë të dukshme shenjat në univers. Prania e të shenjtës shpallet:

"Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë, dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës (duke thënë): "Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i Lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!" (Kur'ani, 3:190-191)

Në zemër të ekzistencës sonë të përditshme, e cila përpëllitet dhe pastaj mbytet në preokupimet më të mbingarkuara, kjo është e barabartë me hedhjen e një hapi pas, me mërgimin e vetes në qendrën e saj, me kërkesën për forcimin e kujtimit të saj, dashurinë dhe njohjen, falënderimin dhe faljen në mes të zhurmës, në kërkim të qetësisë dhe jetës së mbushur me kuptimin e fjalëve:

"Jeto në këtë botë si një i huaj ose si një kalimtar."

Ky dimension shpirtëror me kërkesat që ai shtron, është

në zemër të jetës sonë të përditshme. Çështja është të mos mohojmë asgjë nga qenia jonë, as trupin tonë, as shpirtin tonë, as këtë jetë dhe as jetën që pason. Sprova e shpirtit është një sprovë ekuilibri, nuk është tjetër veçse "rruga e mesme", ashtu sikundër është edhe rruga e të gjitha vështirësive. Disa nuk duan tjetër veçse jetën e kësaj bote, dhe kështu që ata e humbin veten:

"Ka disa prej njerëzve që thonë: "Zoti ynë na jep Ti neve në këtë botë". Për të tillët nuk do të ketë asgjë në botën tjetër." (Kur'ani, 2:200)

Të tjerë, për aq sa u lejon humanizmi i tyre, duan të jenë këtu që të jenë mirë atje:

"E ka prej tyre asish që thonë: "Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në jetën tjetër dhe na ruaj prej dënimit të zjarrit." (Kur'ani, 2:201)

Kjo do të thotë të jetosh jetën tënde të përditshme duke punuar dhe duke formuar vetveten; do të thotë të testosh besimin tënd me veprimet e tua, zemërimet, iluzionet, do të thotë të jesh me Zotin edhe kur je me njerëzit, dhe t'i japësh asaj që njeriu ka, kuptimin e asaj që ai është:

"Dhe me atë që të ka dhënë Allahu përpiku ta fitosh botën tjetër, e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë sikundër të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë se Allahu nuk i do çrregulluesit." (Kur'ani, 28:77)

Kjo do të thotë të jesh me gjithë qenien tënde në këtë botë, duke mbartur dëshminë e besimit tënd nëpërmjet veprimeve të drejta dhe të mira. Pra të mos refuzosh asgjë nga ajo që njeriu është, në mënyrë që të jetosh me qenien tënde të plotë.

"Më i miri nga njerëzit është ai i cili është më i dobishmi ndaj tyre."

Tashmë epoka jonë na sfidon. Shoqëria e zbavitjes, shoqëria e konsumit të tejskajshëm, individualizmit të përgjithësuar bashkë-ekziston me varfërinë dhe mjerimin më total. Përballë këtyre fataliteteve, ku qëndron kuptimi? Mbushur me përkujtimin e Zotit, përgjatë gjithë këtij modernizmi, në cilin burim do të mund ta shuajmë ne etjen tonë? Çdo njeri e njihë humbjen më të madhe të kësaj jete, e cila vret diçka brenda nesh: qëndrimi ulur përpara televizionit, të abuzuar nga një rrymë e fuqishme informacioni dhe të paralizuar nga qëllimi i fraksioneve. Pra të kesh gjetur Zotin, por të jetosh i vdekur. Do të thotë të humbësh mendjen tënde, sepse dikush ka humbur zemrën e tij.

Dikush mbase duhet të jetojë të kotën që të mësojë si të jetë një burrë, si të jetë një grua, në pasqyrën e koshiencës së tij dhe në sytë e atyre që e rrethojnë. Dikush dëshiron kaq shumë të gjejë forcën t'u japë bukuri mendimeve të tij dhe të pastrojë zemrën e tij. Është shpresa dhe pritshmëria e gjithsecilit të jetojë në qetësi dhe të hedhë hapat e tij në qartësi. Në zemër të gjithë këtij modernizmi, pëllëmbët e duarve, durueshëm, drejtohen drejt qiellit.

Një burrë, një grua është thjesht një pyetje ekzistence. Të bëhesh një njeri i mirë dhe të bësh mirë. Cili burrë nuk ka dëshiruar të jetë për partneren e tij një horizont i pritshmërive të saj, të ecë me të në të njëjtin breg dhe nga përkujdesja dhe falja ta kthejnë bashkimin e tyre në një shenjë. Një çift i cili është për njerëzimin ajo çka

dielli është për natyrën: ngrohtësi dhe shenjë e Krijimit.

Në zemër e këtij modernizmi, cila grua nuk ka dëshiruar, me të njëjtin qëllim, të jetë për bashkëshortin e saj energjia e rrugës së tij?

Cila nënë, cili baba, cili prind nuk ka shpresuar për fëmijët e tij mjedisin më harmonik, familjen më unike, dhe më të madhen forcë çliruese? Cili nuk ka dëshiruar të shohë qoftë edhe një herë në sytë e vajzës apo djalit të tij, në thellësi të zemrave të tyre, shkëlqimin që jep falënderimi dhe bindja, të cilat përbëjnë besimin? Në zemër të këtij modernizmi, cili bir apo bijë nuk ka dëshiruar të jetojë midis dy qenieve, i rrethuar nga dashuria e tyre, i ushqyer me vlerat e tyre dhe i fuqizuar nga uniteti i tyre?

Gjëra kaq të thjeshta janë kaq shqetësuese në epokën tonë. Të jesh i mirë dhe të bësh mirë, i gjendur përpara Zotit, ky është kuptimi i kësaj thirrje, kënduar më shumë se 17 herë në ditë, si dje ashtu edhe sot, në zemër të këtij modernizmi:

"Udhëhiqna në rrugën e drejtë!" (Fatiha, 6)

Të ecësh në rrugën e drejtë, rrugën e mesit të drejtë, për të përkujtuar Zotin dhe për të ruajtur në zemrat tona ndjenjën e vlerave dhe finaliteteve. Gjithmonë duke ecur përgjatë saj pavarësisht nga rreziqet dhe kundërshtitë, pavarësisht nga padrejtësitë dhe tmerret, duke besuar Zotin ashtu që të mos dëshpërohesh nga njerëzit dhe ngjarjet. Të ecësh përgjatë saj, sërish e sërish, thjesht një përpjekje për të qenë një burrë dhe një përpjekje për të qenë një grua. Në kthjelltësi dhe qartësi duke pranuar dobësitë vetjake dhe qenien tënde njerëzore, duke gjetur në zemrën e namazit forcën për nënshtrim. Të jesh i nënshtruar dhe përkujtues i gjendur në zemër të modernizmit:

"Ti përmende Zotin tënd heshtaz, me respekt dhe me drojë, jo me shprehje të larta, (përmende) në mëngjes e në mbrëmje dhe mos u bëj prej atyre që nuk kanë kujdes. S'ka dyshim se ata që janë pranë Zotit tënd (engjëjt) nuk tërhiqen prej adhurimit të Tij nga mendjemadhësia. Atë e madhërojnë dhe vetëm Atij i bëjnë sexhde." (Kur'ani, 7: 205-206)

Dhe e gjithë kjo duke u përballuar me të gjitha llojet e individualizmit njerëzor, të gjithë reflekset e konsumit, të gjithë iluzionet televizive e kinematografike dhe të gjithë neglizhencat. Duke refuzuar të gjithë padrejtësitë, në opozitë me të gjithë llojet e shfrytëzimit, duke luftuar kundër të gjithë poshtërsive. Duke thënë dhe ruajtur fuqishëm forcën e nënshtrimit dhe besimit në Zot, pafundësisht gjithmonë. Duke gjetur rrugët për veprim; duke armatosur veten me dritë nëpërmjet durimit. Në vëllazërinë e njerëzve kundër shoqërisë së individëve, në bashkimin e lirisë kundër egoizmit të varësisë. Në zemër të modernizmit, rruga e drejtë: dimensionin ynë shpirtëror, në zemrat tona, qëndron në qendër të jetës.

Duke refuzuar neglizhencat dhe duke dëgjuar, duke dëgjuar thellë, përtej heshtjeve të kohërave, duke dëgjuar dhe duke mbajtur vesh, zërin e skllavit të dikurshëm, Bilalit që thërret besimtarët në besimin e tyre, pesë herë në ditë, përjetësisht... Duke kërkuar në jehonën e këtij zëri dhe në ritmin e faljeve, duke kërkuar dhe gjetur drejtimin e rrugën, në zemër të modernizmit.

Përktheu: Haki Sahitaj




Kuptimi i jetës

C'është kuptimi i jetës? Një pyetje kjo që zë fill që në gjenezën e krijimit të njeriut dhe është e rëndësishme sa vetë ekzistenca e tij. Kur flasim për kuptimin e jetës si koncept duhet ta veçojmë atë nga përjetimi i një kuptimi në lidhje me jetën. E para lidhet me qëllimin e jetës që formësohet rreth një besimi fetar apo një mendimi filozofik të caktuar. Ndërsa të përjetuarit e një kuptimi në lidhje me jetën është i pranishëm te të gjithë njerëzit, ku edhe për ata që nuk besojnë, jeta ka një kuptim. Ata që e humbin kuptimin e jetës, humbin edhe dëshirën për të jetuar dhe prej kësaj lind një gjendje e sëmurë. Viktor Frankl, ishte i pari që e sistematizoi shkencërisht këtë gjendje duke e konceptualizuar në aspektin psikologjik dhe filozofik. Këtë shkencë e emërtoi si logoterapi dhe

e vendosi brenda fushës së psikoterapisë si "terapi e kuptimit".

Po si lindi kjo ide? Kur Viktor Frankl shkoi bashkë me pjesëtarët e familjes në kampet e nazistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku ndoshta çdo ditë vdisnin apo vriteshin një apo dy njerëz në ditë, ai brenda asaj atmosfere vëzhgoi gjendjet e njerëzve midis jetës dhe vdekjes. Duhet theksuar se ai më parë ai kishte qenë doktor në spitalet e Vjenës, ku ishte njohur me Frojdin, Adlerin dhe mendimet e tyre. Ai i pranonte deri diku mendimet e tyre dhe ishte i vetëdijshëm për ndikimin që ato kishin mbi të sëmurët. Siç dihet, këta të fundit jetuan në një kohë pa luftëra dhe patën bërë psikanalizën e njerëzve gjatë një jete normale. Kështu, ata folën dhe



ndërtuan teoritë e tyre duke marrë parasysh dëshirat apo idealet dhe qëllimet e njerëzve për vetërealizimin. Por, Viktor Frankl vëzhgoi ato momente të njerëzve midis jetës dhe vdekjes ku e vërteta shfaqet e pastër. Kështu, ai kuptoi se përtej dëshirave të egos apo ndjenjave që lidhen me vetërealizimin, për njeriun është më e rëndësishme ti ngarkojë një kuptim jetës së tij.

Ai e tregon kështu një vëzhgim të tijin: një pjesë e njerëzve në atë kamp, trajtoheshin në mënyrë të veçantë. Si shpërblim për punën, atyre u jepnin cigare. Kur disa prej tyre merrnin të pinin cigaret, të cilat i kishin ndërruar me racionin e përditshëm të ushqimit, ne kuptonim se ata do vdisnin për disa ditë sepse kishin humbur dëshirën dhe qëllimin për të jetuar. Pra, ai kuptoi se: duke i ngarkuar një kuptim të jashtëzakonshëm momenteve të caktuara kohore dhe duke braktisur krejtësisht të ardhmen, sakrifikimi i çdo gjëje nga njeriu për kënaqësinë e çastit, tregon se atij i është mërzhitur jeta dhe ajo nuk ka më vlerë për të. Kjo teori e Viktor Franklit është përdorur më pas si metodë për të shëruar të sëmurët nga ana psikologjike. Ajo nuk është një metodë që i dikton një kuptim të caktuar njeriut për jetën e tij, por i mëson atij metodat se si ai duhet ti ngarkojë një kuptim jetës së tij.

Çfarë i jep kuptim jetës sonë?

Le të supozojmë se qëllimi ynë epror i jetës është lartësimi i racës sonë. Por, nëse jetojmë në një vend të huaj, njerëzit përreth nesh i përkasin kombësive të ndryshme. Pra, pavarësisht se është një ideal i madh që përfshin shumë gjëra, ai e helmon jetën e njeriut gjatë përditshmërisë. Edhe sikur në një vend të jetojnë njerëz të së njëjtës racë, në botë ka shtatë miliard njerëz. T'i shikosh të gjithë ata si armiq dhe të hamendësosh për planet e tyre kundër teje është me të vërtetë problematike për mënyrën se si një njeri e percepton botën dhe jetën e tij.

Një perceptim tjetër i jetës është ai i humanizmit i cili ka në qendër të mendimit njeriun e për rrjedhojë, njerëzit e shikojnë njëri-tjetrin si vëllezër. Këtu ekziston mundësia për të neglizhuar elemente të tjerë jashtë njeriut si mjedisi etj. Në anën tjetër, nëse njeriu i jep kuptim jetës nëpërmjet ambientalizmit, mund të ndodhë që duke i dhënë përparësi mjedisit të neglizhohet angazhimin me problemet personale të njeriut. Po ashtu, në teoritë që kanë qendër njeriun mund të ketë aspekte që neglizhojnë brendësinë dhe botën shpirtërore të tij.

Një formë tjetër është kur njeriu nuk mbështetet në kuptime apo teori të mëdha, por e percepton jetën duke i ngarkuar asaj kuptime të vogla. Këto të fundit ndërsa mjaftojnë në momente të caktuara për të përjetuar kuptimin e jetës, mund të mos i mjaftojnë njeriut kur përballet me problemet dhe fatkeqësitë e mëdha në jetë si vdekja, ndarja, emigrimi, papunësia etj. Pra njerëzit të cilën gjejnë lumturinë në momente të vogla janë njerëz të mirë dhe të këndshëm, por kur përballet me fatkeqësi,

të mëdha mund të mos i përballojnë duke qenë se nuk kanë ideale të mëdha dhe nuk mendojnë në bazë të kuptimeve gjithëpërfshirëse.

Pra, njeriu duhet t'i japë një kuptim të tillë jetës që edhe të përcaktojë parimet e përgjithshme, por edhe t'u japë kuptim momenteve të vogla, saqë çdo gjë nga momenti më i vogël deri të idealet më të mëdha të ketë kuptim. Për më tepër, ky perceptim duhet t'i japë kuptim gjendjes së qenies së njeriut edhe pas vdekjes. Kështu, mund të thuhet se vetëm besimin te Zoti i mundëson njeriut të ketë një perceptim gjithëpërfshirës për çdo aspekt të jetës së tij.

Le të përmendim disa shembuj nga jeta e Profetit tonë të dashur për të parë se si merr kuptim jeta e njeriut duke pasur besimin te Zoti në qendër të saj.

Profeti Muhamed a.s kishte një djalë me emrin Ibrahim nga Hz. Maria. Ardhja e tij në jetë do ta gëzonte shumë të Dërguarin e Allahut. Por pas një kohe të shkurtër ai do të ndërronte jetë. Po atë ditë do të ndodhe eklipsi i diellit. Kur njerëzit u përballën me diçka të tillë thanë se ndërroi jetë djali i Profetit a.s, prandaj u zhduk dhe dielli në shenjë zie për të. Në fakt kjo mund të duket diçka e bukur kur njeriu mendon se Zoti nuk e shfaq diellin në shenjë zie për fatkeqësinë që e ka goditur robin e tij. Por, Profeti Muhamed a.s nuk donte që ti ngarkonte një kuptim një gjëje kur Allahu nuk e kishte bërë diçka të tillë dhe donte t'i orientonte mendimet e njerëzve krejtësisht drejt besimit te Zoti. Ai nuk e miratoi një mendim të tillë dhe i tregoi këndvështrimin dhe perspektivën e duhur duke i thënë: "Dielli dhe Hëna janë argumentet e Zotit. Ato nuk eklipsohen për vdekjen apo për lindjen e askujt". Pra, Profeti a.s në sajë të imanit në zemrën e tij dhe perceptimit që përftonte prej tij, arriti t'i japë kuptim dhe të interpretojë një ngjarje të jashtëzakonshme.

Një herë tregohet se Profeti Muhamed a.s ishte me nipin e tij, Hz. Hasanin të cilin e donte shumë dhe ky i fundit i ngjante shumë atij për nga cilësitë fizike dhe temperamenti. Ndërsa Profeti Muhamed a.s po e përkëdhelte dhe puthte Hz. Hasanin, e panë disa beduinë të cilët u habitën dhe i thanë se ne kemi shumë fëmijë dhe nuk e kemi bërë asnjëherë diçka të tillë me ta. I Dërguari i Allahut u përgjigj: "Ç'mund të bëj unë nëse Allahu e ka e hequr ndjenjën e mëshirës prej zemrës suaj?!" Në një ngjarje tjetër, kur përballet me të njëjtën situatë ai tha: "Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet". Pra nëse nuk i mëshiron ata që janë në tokë nuk mëshirohesh nga Allahu dhe engjëjt që janë në qiell.

Kështu, këto parime i mundësojnë njeriut një perceptim gjithëpërfshirës të çdo gjëje, të vogël apo të madhe në jetën e tij, Ato janë dritë e mendjes dhe frymëzim i shpirtit për të formësuar jetën dhe krijuar një botë më të lumtur, më të mirë dhe të bukur, e cila është reflektim i lumturisë absolute që njeriu synon ta arrijë përjetësisht në botën e përtejme.

Përshtati: Abdullah Bulku



Nepotizmi në Administratë

HZ. IJAD IBN GANM R.A

Nga e kaluara në të sotmen, ka disa gabime të përsëritura që e çojnë shtetin, kombin, qytetërimin dhe institucionet në kolaps. Pamundësia për të mbajtur ekuilibrin midis idealeve dhe realitetit, veprimet e përditshme, izolimi, përdorimi i paplanifikuar dhe pa projekte të burimeve, paaftësia për të trajnuar njerëz të drejtë dhe të specializuar në fushën e tyre ose duke mos ukushtuar vëmendje kualifikimeve në detyrat e tyre, mosqenia në gjendje për të lexuar ndryshimet dhe transformimet rajonale dhe globale në kohë dhe në mënyrë korrekte, mospërkrahja sa duhet e njerëzve të cilët mendojnë dhe prodhojnë, mania për kënaqësi dhe konsum, shpërdorimi në shpenzime financiare dhe pasioni për luksin... janë disa nga këto. Megjithatë, ka një gabim për të cilin do të tërheqim vëmendjen në këtë artikull, i cili është një nga arsytet më të rëndësishme të kolapsit dhe trazirave gjatë historisë së njerëzimit: nepotizmi në administratë.

Kur'ani dhe Suneti, të cilët nuk janë indiferent ndaj asgjëje që çon në rrënimin e individit dhe shoqërisë, përmblajnë disa urdhëra dhe ndalesa për të mos infektuar shoqërinë Islame me këtë virus vdekjeprurës që do të shkatërrojë besimin në administratë. Ai përcakton parimet dhe procedurat që duhet të merren parasysh në punësimin e njerëzve, si teorikisht ashtu edhe praktikisht, në një mënyrë të qartë që nuk do t'u hapë derën interpretimeve personale. Para së gjithash, Kurani thotë: "Allahu ju urdhëron t'u jepni amanetet pronarëve të tyre të ligjshëm..."¹ dhe kështu tregon kriterin më themelor: kompetencën/meritën!

Detyra nuk i jepet atij që do, por atij që është kompetent!

Kur u pushtua Meka, xhaxhai i tij, Abbasi r.a dhe dhëndri i tij, Aliu r.a kërkoi të merrte detyrën e "Hixhabes" pra mabijtja e çelsave të Qabes dhe kujdesi për të, e cila deri atë ditë ishte në familjen e Osman Ibn Talhasë. Para se të shpjegonte vendimin e tij për këtë çështje, sapo hyri brënda në Qabe, të Dërguarit të Allahut i zbriti ajeti që përmendëm më lart. Duke dalë nga Qabeja, ai ua reciton këtë varg njerëzve që e prisnin; tërheq vëmendjen te parimi i kompetencës, autoritetit dhe meritës në punësim. Pastaj çelësat e saj ja dorëzon përsëri Osman Ibn Talhas r.a.²

I Dërguari i Allahut vepron në kuadër të këtij urdhri që nga dita e parë për punësimin e njeriut; Në ndarjen e detyrave, ai nuk shikon afërsinë, fisin, racën dhe moshën e njerëzve, por më tepër meritën, kompetencën dhe autoritetin e tyre. Për shembull, kur u çlirua Meka, pavarësisht nga të afërmit dhe shokët e tij të shquar ai ja dha detyrën e prefektit\guvernatorit të qytetit Attab Ibn Asidit i cili ishte në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare. Performanca e Attabit në administrimin e Mekës tregon në një kohë të shkurtër se sa e saktë ishte kjo zgjedhje. Kështu që edhe në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit r.a, ai gjithashtu vazhdoi detyrën e tij si guvernator i Mekës për shkak të administrimit të suksesshëm në kohën e Profetit a.s.

Është tradhëti të mos ja japësh vendin e punës atyre

1. Sureja Nisa 4\58

2. Muslim, Haxh 390

që janë kompetentë!

Krahas praktikave të tij, i Dërguari i Allahut herë pas here në deklaratat e tij tërheq vëmendjen në këtë çështje për të krijuar këtë ndjeshmëri në shoqëri.

Një ditë, teksa ishte duke u takuar me shokët e tij, i erdhi një beduin\fshatar dhe e pyeti: "Kur do të vijë Kijameti?" Kur e mbaroi fjalën, iu drejtua beduinit\fshatarit që i bëri pyetjen dhe i tha: "Priteni kijametin atëherë kur amaneti u është dhënë të paafteve!"³

Përsëri, ai e sjell çështjen në punësimin e njerëzve dhe thotë: "Nëse një person që sundon kombin, i jep një punë dikujt kur ka një tjetër që mund ta bëjë më mirë, ai/ajo do ta tradhtojë Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët."⁴

Gjatë dërgimit të Jezid Ibn Sufjanit në Damask si komandanti i ushtrisë, Ebu Bekri r.a së pari i jep disa këshilla. Pastaj e paralajmëron me këto fjalë: "O Jezid!.. Ti ke të afërm. Por unë jam i shqetësuar se ju mund t'i preferoni ata ndaj të tjerëve dhe t'i punësoni në punët publike. (Kujtoni se) I Dërguari i Allahut ka thënë: 'Kushdo që favorizon një të afërm dhe e emëron atë në punë si rezultat i favorit, ndërsa sundon muslimanët, bie nën mallkim të Allahut. Prandaj, Allahu i Madhëruar nuk do të pranojë asnjë justifikim apo shpërblim prej tij në Ditën e Gjykimit dhe do ta hedhë atë në Xhehenem."⁵

Përsëri Omeri r.a thotë: "Nëse një person nën sundimin e myslimanëve favorizon një njeri për hir të miqësisë ose fafëfnisë dhe e vë atë në krye të një pune, ai është duke tradhtuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe muslimanët"⁶ dhe kështu tërheq vëmendjen për rrezikun e nepotizmit në administratë.

Hz. Ijad, sahabiu që preferoi kafshimin e kobrave për të mos prekur në pronën publike

Provat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij në këtë temë formuan një vetëdije të plotë tek sahabët. Gjëja e parë që ata shikonin kur punësonin njerëz ose linin dikë si përfaqësues ishte kompetenca e adresuesit. Për shembull, Ebu Ubejde Ibn Xherrahu r.a pak para vdekjes, emëroi si zëvendës të tij Ijad Ibn Ganmin r.a i cili u bë mysliman pak para marrëveshjes së Hudejbijes. Ijadi r.a, me moralin e tij të mirë, me seriozitetin e tij në detyrat administrative që i ishin dhënë deri në atë ditë dhe me sukseset e larta ushtarake tërhoqi vëmendjen e Ebu Ubejdës r.a.

Kur kalifit Omer r.a i erdhi lajmi i vdekjes së guvernatorit të Damaskut Ebu Ubejde bin Xherrah r.a, ai tha: "Askush nuk mund të të zëvendësojë". Më pas pyet se "Kë caktoi pasardhës në vend të tij?" Pasi i thonë emrin e Ijad Ibn Ganmit r.a, Omari r.a e miraton atë menjëherë dhe i shkruan një letër: "Të kam emëruar guvernator në vend të Ebu Ubejda Ibn Xherrahut. Në këtë drejtim, veproni gjithmonë sipas urdhrit dhe të vërtetës së Allahut!"⁷

3. Buhari, Ilm 2

4. Hakim, Mustedrek 4/104 (7023); Taberani, Kebir 11/114; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid 5/212

5. Ahmed Ibn-i Hanbel, Müsned 21

6. Ibn-i Kethirr, Musnedu'l-Faruk 2/536

7. Ibn-i Sa'd, Tabakât 5/70, 71

Ijadi r.a ishte një person tolerant, bujar dhe trim. Nga njëra anë ishte i kujdesshëm për të mirat publike, të drejtat dhe ligjin e tij dhe nga ana tjetër ishte një administrator i ndjeshëm që përdor mjetet e tij personale për të plotësuar nevojat e nevojtarëve që e rrethojnë. Aq sa një ditë shërbëtori i tij i cili erdhi tek ai pasi u kishte shpërndarë të varfërve atë që kishte, e i tha se "Nuk kemi më çfarë të hamë!" Ijadi r.a heq rrobën e tij dhe i thotë: "Shite këtë dhe blej miell me paratë." Ata që ishin dëshmitarë të ngjarjes thanë: "Subhanallah! A nuk do të ishte më mirë nëse deri nesër të përdorësh nga mallrat që qëndrojnë në qoshe, pa shitur rrobën tënde dhe më pas t'i zëvendësoje?" Ijadi r.a i tha: "Më mirë do të fusja dorën time në gojën e një kobre që të më kafshojë sesa të bëj atë që thua ti! Sepse malli dhe paratë në atë qoshe janë të thesarit të shtetit dhe pronë publike."

Ai e siguronte bukën e gojës duke shitur diçka nga pasuria e tij derisa i vjinte koha e rrogës dhe merrte shumën që i ishte caktuar. Ata që e shihnin kur merrte rrogën mendonin se ai është i pasur. Por kur e shikonin pas disa ditësh, mendonin se ishte shumë i varfër. Sepse sapo e merrte rrogën, ua shpërndante nevojtarëve deri në qindarkën e fundit. Për shkak të kësaj bujarie të tij njerëzit u ankuan tek kalifi Omer r.a. me preteksin se Ijadi r.a është shumë shpërdorues dhe nuk mban asgjë në dorë.

Ndërsa Omeri r.a u tha: "Bujaria e Ijadit lidhet me pasurinë e tij. Sa i përket pasurisë publike, ai kurrë nuk e prek atë. Prandaj, nuk mund ta shkarkoj një guvernator të drejtë dhe kompetent me këtë preteks!"⁸

Pranoj të pritem në dyshë me sharrë dhe pronën publike nuk e prek!

Kur Ijadi r.a emërohet si guvernator, një grup njerëzish nga familja e tij e ngushtë vijnë tek ai. Ata i kërkojnë që ai ta mbajë të fortë lidhjen farefisnore dhe të jetë i mirë me ta. Ai i mirëpret me gëzim të afërmit e tij që kanë ardhur nga një rrugë e largët dhe u ofron dhuratat. Pas disa ditësh, ata i shpjegojnë arsyt kryesore të vizitës. Pas kësaj Ijadi r.a u jep nga dhjetë dinarë secilit prej pesë anëtarëve të delegacionit.

Të afërmit e tij ia kthejnë në shenjë proteste sepse kishin pritshmëri më të larta dhe inatosen me të. Përballë këtyre qëndrimeve Ijadi r.a i thotë: "O bijtë e xhaxhallarëve! Nuk i mohoj lidhjet farefisnore, të drejtat tuaja dhe vuajtjen tuaj duke ardhur nga larg. Megjithatë, unë munda t'ju jap ato para duke shitur një sklav dhe një pronë që ishte një nga nevojat e mia themelore. Kështu që të më falni por nuk mundem më shumë." Më pas, të afërmit e tij thanë: "Betohemi se Allahu nuk do të justifikojë. Sepse ti jeni guvernatori i gjysmës së Damaskut (Sirisë, Palestinës dhe Jordanisë së sotme). Por ti na jep shumë pak para sa që nuk mjafton të kthehemi te familja jonë."

Pritshmëritë e tyre nga ai ishin që të përdorte fuqinë postit të tij dhe t'u jepte atyre dhuratat të bollshme nga buxheti i shtetit. I vetëdijshëm për situatën, Ijadi r.a i tha: "Ju dëshironi që unë të vjedh nga prona publike. Ndërsa unë do të preferoja të më sharronin ashtu si sharrohen drutë për tu bërë një anije sesa të tradhtoja një qindarkë të shtetit/popullit ose ti hyja në hak të drejtave të një muslimani apo një jomuslimani të këtij shteti."⁹

Të paktën na jepni një punë në shtet!

Por ata nuk donin ta kuptonin apo pranonin ndjeshmërinë e Ijadit r.a për këtë çështje. Kështu që, këtë herë i thanë: "Ne të kuptojmë dhe të falim për mundësitë tuaja personale shumë të kufizuara dhe ndjeshmërinë tënde ndaj pronës publike. Por të paktën na jep një post në zyrat e shtetit! Ne paguajmë taksa siç bëjnë njerëzit e tjerë për të ardhurat e tyre dhe të përfitojmë nga pozicioni i tyre ashtu si përfitojnë edhe të tjerët. Ti e di dhe e sheh situatën tonë. Ne nuk do të donim asgjë më shumë përveç detyrës që do të na japësh."

Përveç ndjeshmërisë së çështjes sipas ligjit të drejtë dhe frikës së llogarisë së Ahiretit, Ijadi r.a i kujton atyre se sa i ndjeshëm ishte prijësi i muslimanëve, kalifi Omer r.a për "nepotizmin në administratë" dhe i thotë: "Pasha Allahun, me sa di unë, jeni njerëz të virtutshëm. Megjithatë, nëse shkon lajmi tek kalifi Omer r.a se unë kam favorizuar një grup nga të afërmit e mi, ai do të mërzitej shumë më mua dhe me të drejtë do të më dënonte. Unë, nga ana tjetër, nuk mund të përballoj që kalifi i të Dërguarit të Allahut a.s të më dënojë për këtë gjë."¹⁰ Kështu, ndonëse vonë, të afërmit e tij e kuptojnë seriozitetin e çështjes dhe ashtu të mërzitur largohen nga ai.

Gjatë qeverisjes së tij, Ijad Ibn Ganmi r.a arriti sukses të mëdha në lartësimin e shtetit Islam dhe ndërroi jetë në vitin e 20-të të hixhretit, në moshën 60-vjeçare, pa lënë pas asnjë pronë dhe asnjë borxh.

Rezultati

Sipas Islamit, kur punësohen njerëzit, "kompetenca dhe merita" janë dy elemente thelbësore. Kur'ani dhe Suneti në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje i urdhërojnë besimtarët që ta bëjnë këtë. Ata që i formësojnë ndjenjat dhe mendimet e tyre në bazë të Kur'anit dhe Sunetit, si dhe ata që marrin shembull të Dërguarin e Allahut a.s, duhet të insistojnë të bëjnë gjënë e duhur në këtë çështje, pavarësisht nëse bashkëbiseduesit e tyre ofendohen apo mërziten. Përndryshe, për ta, bie në sferën e shpërdorimit të pushtetit dhe tradhtisë së besimit. Për të afërmit e tyre të favorizuar do të thotë të zënë pa të drejtë një zyrë shtetërore dhe të gllabërojnë pa të drejtë pasurinë publike.

Shpirtrat e ndjeshëm si Ijadi r.a veprojnë me shumë kujdes dhe përpikëni të përmbushin detyrën që u është besuar pa cenuar të drejtat e askujt. Nëse duan t'u bëjnë mirë të afërmit e tyre që vijnë tek ata, do ta përballojnë atë nga mjetet e tyre personale. Me gjithë insistimin dhe pakënaqësitë e tyre, nuk ua dhurojnë të afërmit e tyre zyrat në të cilat drejtohen punët e shtetit dhe pasurinë publike. Në çështjet e interesit publik, ata ia besojnë punën personit më të drejtë dhe më kompetent. Sepse Kur'ani thotë: "O ju që keni besuar! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe mos i tradhtoni me vetëdije amanetet tuaja! Dijeni se prona juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një provë. Shpërblimi i madh është tek Allahu në botën tjetër."¹¹

8. Ibn-i Sa'd, Tabakât 5/72

9. Ibn-i Sa'd, Tabakât 5/71

10. Ibn-i Sa'd, Tabakât 5/72

11. Sureja Enfal 8/27,28



KIAMETI

EXHELI I UNIVERSIT

shkaqe për ndodhjen e Kiametit. Fenomene të tilla natyrore kanë ndodhur dhe ndodhin në të gjithë sistemet planetare, të ngjashme apo jo me sistemin tonë diellor, të cilët janë numerozë, si në galaktikën tonë, ashtu edhe në miliardat galaktikat në Gjithësi. Dhe apokalips nuk ka patur. E ç'shkatërrim mund t'i sjellë një ndërtese madhështore puna e zakonshme modifikuese që mund të bëhet në ndonjë nga dhomëzat e saj? Është naive të besosh fantazi të tilla.

Aktualisht, më i diskutuari është skenari "i shkatërrimit" që do të shkaktojë planeti X (Nibiri). Së pari ky shkatërrim që paralajmëruar në vitin 2003, por që nuk ndodhi. Tërheqës e bën këtë parashikim lidhja me botëkuptimin dhe kalendarine fisit prehistorik Maya, duke përcaktuar edhe datën 21. 12. 2012. Mendohet që planeti X do t'i afrohet Tokës dhe do ta fusë atë nën gravitetin e vet. Si pasojë do të ketë tërmete dhe Pjesa e parë

"Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja dhe Ai, me fuqinë e Tij, mund t'i bashkojë kurdo që të dëshirojë." (Kuran, 42/ 29)

"Çdo send zhduket e Ai jo. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të ktheheni. (Kuran, 28/ 83)

Historia e Universit vazhdon me fazën e tij të fundit, Kiametin. "Thuaj: "Po! Pasha Zotin tim, që e di të fshehtën! Patjetër do t'ju vijë ai (kijameti) juve. Atij nuk mund t'i fshihet as në qiej e as në tokë sendi sa grimca, e as më i vogël e as më i madh, vetëm se janë regjistruar në Librin e Qartë." (Kuran, 34/ 3)

Kiameti objekt diskutimesh dhe polemikash Por, "Ata vetëm fantazojnë." (Kuran, 45/ 24)

Çështja e "Kiametit" (Katastrofës së Madhe) i ka preokupuar njerëzit, të çdo shtrese shoqërore, të çdo niveli kulturor e të çdo kohe. Konceptimet dhe përfytyrimet mbi të kanë qenë të lloj-llojshme, si nga besimtarë, si nga ateistë, supersticiozë etj. Çdonjëri në vetvete, nën presionin e të ardhmes së fshehtë, ndjen ankthin për fatin që do të ketë. I luatur ndërmjet dëshirës për përjetësi dhe kërcënimit të vdekjes sësigurt që e pret, njeriu mendon dhe krijon bindje e besim, qoftë për ardhmërinë e vet, qoftë edhe për destinacionin e Universit, duke e parë veten të lidhur ngushtë me tokën dhe qiejt. Herë-herë ai ka ndërje

nevojën e njoftimit nga Krijuesidhe herë-herë i është nënshtruar egos, falë lirisë së dhuruar për të menduar. Mediton, arsyeton, hedh ide, formulon hipoteza, ndërton filozofi, flet me vetveten dhe diskuton e debaton me tjetrin. Këtë natyrëdilematike, kontradiktore e të turbullt tëindividit dhe të shoqërisë njerëzore, e përshkruan mjaft bukur Zoti në shumëajetekuranore. "Për çka i bëjnë pyetje njëri-tjetrit? Për lajmin e madh e tronditës! Jo, të mos pyesin, sepse ata do ta kuptojnë..." (Kuran, 78/ 1-4) "Ata edhe thanë: "Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë e jona në këtë botë. Po vdesim e po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër përveç kohës!" Ata për këtë nuk dinë asgjë!" (Kuran, 45/ 24) "Ata që nuk i besojnë atij (Kiametit), kërkojnë ngutjen e tij. Ndërsa ata që i besojnë, frikësohen dhe e dinë se ajo është e vërtetë. Ta dini se ata që bëjnë polemikë, duke dyshuar në momentin e katastrofës së përgjithshme, janë në një humbje të thellë." (Kuran, 42/ 18)

Si për të vërtetuar se Kurani i flet çdo kohe dhe, gjithashtu, për të pasuruar me fakte këto ajetekuranore të 14 shekujve më parë, atmosfera e polemikave lidhur me Kiametin mbetet po ajo, siç u përshkrua më lart. Në çdo kohë, nëçdo shekull, janë bërëpafund parashikime për momentin e ndodhjes së apokalipsit, si dhe janë dhënë edhe skenare të ndodhjes së tij.Mjaft të përmendim shembuj të periudhës së qytetërimit modern, edhe pse ai mbështetet në zhvillimet shkencore e teknologjike. Në këtëaspekt, kjo periudhë e historisë së njerëzimit nuk mbetet prapa errësirës mesjetare apo edhe më herët. Në shekullin e kaluar dy herë u shqetësuan dhe frikësuan njerëzit (në fillim dhe në fund të shekullit) nga parashikimi "shkencor" i katastrofës, për shkak të afrimit të kometës "Hallej". Kjo kometë çdo 72 vjet viziton sistemin tonë planetar, por nuk shkakton ndonjë efekt "negativ" për jetën në tokë, përveç se me bishtin inkandeshent zbukuron qiellin e netëve tokësore. Ndërsa në këtë dekadë të parë të shekullit të ri janë bërë parashikime të fundit të botës për vitin 2000, 2003, 2011, 2012, 2013 etj. HaroldCamping, anëtar i sektitkristian"Dëshmitarët e Jehovait", parashikoi fillimisht 6 shtatorin e 1994 si datë të fundit të botës. Më pas përcaktoi se 21 maji 2011 do të ishte dita e parë e një periudhe pesë mujore e gjykimit të Perëndisë mbi tokë, për t'i dhënë fund më 21 tetor 2011. Sjellim këtu edhe njëparashikim, që mendohet se është bërë nga kolosi i fizikës klasike Isak Njutoni. Sipas një dorëshkrimi ai, i nxitur

nga dëshira për të nxjerrë informacion shkencor nga Bibla, konkludoi se bota do të shkatërrohet jo më parë se viti 2060.

Përveç këtyre parashikimeve për kohën e ndodhjes së fundit të botës, janë dhënë edhe skenare se si mund të ndodhë apokalipsi. Në faqe të tëra gazetash e revistash, apo në dokumentare televizivë flitet herë për 5 skenare të mundshme e herë për 12 skenare të fundit të botës etj. Mjaft sipërfaqësisht po rendisim disa parashikime për apokalipsin, të cilat keqpërdorin një bazë shkencore për t'u bërë më të besueshme. 1. Stuhitë diellore (parashikohet se do të ndodhë në 2013); 2. Viruset (përdorimi i armëve biologjike); 3. Ngrohja globale; 4. Rrezatimi gama; 5. Inteligjenca Artificiale; 6. Ndërrimi i poleve të tokës; 7. Konflikti bërthamor; 8. Planeti X (Nibiri); etj. Me të drejtë Krijuesi i Lartësuar na përkujton dhe na qetëson në Kuran: "Ata vetëm fantazojnë." (Kuran, 45/ 24) Me esnafllëk, duke shfrytëzuar ndjeshmërinë e madhe të publikut lidhur me këtë çështje, mediat e shkruara dhe elektronike pasurojnë faqet dhe ekranet me lloj-lloj fantazish apokaliptike, për të rritur tirazhin, shikueshmërinë apo numrin e klikimeve në uebsitë dhe në rrjetet sociale, pa u shqetësuar aspak për efektet në shoqëri. Kjo, përveç që bëhet për qëllime fitimi, shton ankthin, shqetësimin dhe çorodit një masë të madhe njerëzish. Për t'i bërë më të besueshme fantazitë e tyre, ato i manipulojnë me copëza studimesh shkencore për dukuri të veçanta.

E përbashkëta e gjithëskenareve të publikuara (disa u përmenden më sipër) është se asnjë prej tyre nuk ka të bëjë me Kiametin Kuranor, në të cilin besojnë myslimanët, apo edhe me modelin shkencor teorik të Gjithësisë së Mbyllur. Që të gjithë bëjnë fjalë për një "shkatërrim" lokal në planetin tokë, apo për shqetësimet të jetës së zakonshme të njerëzimit në tokë, ose për "çrregullime" në sistemin tonë diellor, domethënë për shkatërrim me në qendër njeriun. Ky as nuk është e as nuk mund të quhet Kiamet - "Fund i Botës". Por edhe ndërmyslimanët hasen tek tuk predikues që përmenden skenaret e mësipërme si vërsime, që do të sjellin shkatërrim. Në të njëjtën datë parashikohet të ndodhë këmbimi i poleve të Tokës, gjë që shoqërohet me të njëjtat pasoja: tërmete, cuname, përbytyje e katastrofa. Nga ky përshkrim, vërtet pasojat duken të tmerrshme për njeriun, por nuk përbëjnë Kiamet, pasi këto nuk kanë ndonjë bazë të besueshme, qoftë kjo edhe shkencore. Panorama që jepet nuk shkon më tej se sa një fotomontazh i përjetimeve të katastrofave natyrore, që janë të përvitshme në zona të ndryshme të planetit tonë. Kërkuesi shkencor dr. Manuel Floris shpjegon: "Nëse do të hipotezojmë ekzistencën e një planeti që "rastësisht" u ka shpëtuar vrojtimeve këmbëngulëse të astronomëve, mund të themi me siguriqë, nëse ky do të ishte në trajektore drejt Tokës për ta goditur pas afro një viti, atëherë tani duhej të gjendej në një distancë të tillë nga Toka, për t'u parë me sy të lirë, si një yll i ndritshëm. Megjithatë në sistemin tonë diellor nuk është zbuluar asnjë planet i ri, mund të përjashtojmë që në 2012 Toka të mund të shkatërrohet nga përplasja me një planet të panjohur. "E si mund të hynte "i panjohuri", për të bërë dëme në shtëpinë 10 anëtarëshe, pa hasur në të zotin vigjilent të shtëpisë! Sigurisht që planeti X mund të sjellë shqetësimet psikologjike e lajthitje mendore të një grushti njerëzish, por kurrsesi shkatërrime të Tokës e, aq më e pamundur të sjellë fundin e botës, siç propagandohet. Gjithashtu dr. Manuel Floris shprehet edhe për mundësinë që rritja e aktivitetit diellor të shkaktojë apokalips: "Satellitët artificialë në orbitën përreth Tokës kanë

matur që ndryshimi i energjisë së thithur nga Toka, midis minimumit dhe maksimumit të ciklit diellor është rreth 0.25%. Ky ndryshim i energjisë shkakton disa ndryshime klimatike në atmosferën tokësore, por nuk është në gjendje të shkaktojë asnjë katastrofë globale." Ndërsa prof. Luciano Burderi, profesor i asociuar i astronomisë dhe astrofizikës në Universitetin e Cagliari, shton: "Megjithatë, mund të pohojmë se nën dritën e njohjeve shkencore aktuale, astronomët nuk presin asnjë nga këto ngjarje katastrofike për 2012."

Edhe në fetë e ndryshme besohet në Kiametin, e sidomos në tre besimet e quajtura monoteiste, por ka plot dallime në konceptime. Hebrejtë dhe të krishterët, për shkak të devijimeve që i bënë shpalljeve përkatëse, nuk u frenuan dhe nuk e përbajtën dot veten të bëjnë pafund parashikime për apokalipsin. Krejt ndryshe ka ndodhur me myslimanët. Besnikë e të qëndrueshëm në fenë e Zotit, plot besim në Kuranin-Shpallje të Mëshirëplotit, myslimanët nuk shkojnë aq larg, me një fantazi të shfrenuar, sa të flasin për të fshehtën (gajbin) e pamundur, që është atribut vetëm i Krijuesit të Plotëfuqishëm e të Gjithëditur. Nuk është dëgjuar, qoftë edhe një mysliman të parashikojë Kiametin. Myslimanit i mjafton besimi se ai do të ndodhë. Në Kuran, Zoti e klasifikon ndodhinë e Kiametit si të parën nga pesë të fshehtat, d.m.th. që kjo Dije e Allahut është e pamundur nga krijesat. "S'ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë Kiameti. Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç'ka bie në mitra (të nënave). Nuk e di kush pos Tij se ç'ka do të ndodhë (ç'ka do të punojë) nesër. Dhe, askush nuk e di pos Tij se në ç'vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i djshmi, më i njohuri." (Kuran, 31/ 34)

Kur dikush e pyeti peygamberin Muhamed (a.s.) se kur do të ndodhë Kiameti, mori këtë përgjigje shteruese për preokupimin e brendshëm: "Çfarë ke përgatitur ti për atë Ditë?!" Ky është koncepti i qartë islam për Kiametin. Për myslimanin, qendra e gravitetit e të menduarit për Kiametin është si t'i përgjigjet pyetjes së peygamberit Muhamed, sepse në çdo çast njeriu ka pranë "kiametin e vogël" - vdekjen. Komentet pas përgjigjes profetike janë të tepërta.

Sigurisht që, brenda çaqeve të dijës së domosdoshme njerëzore, Allahu e ka informuar njeriun me të vërtetat që u përkasin edhe fshehtësive. Kiameti është njëra nga këto të vërteta. "Dhe nuk ka dyshim se Kiameti do të vijë patjetër..." (Kuran, 22/ 7) "S'ka dyshim se momenti (Kiameti) do të vijë patjetër. Unë gati e kam fsheh atë. (Do të vijë) për t'u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë. (Kuran, 20/ 15) "S'ka dyshim se Dita e Gjykimit është caktuar." (Kuran, 78/ 17) Pra, Kiameti është aq i vërtetë, sa ç'është e vërtetë vdekja për çdo njeri. Përtej kësaj vërtetësie, të flasësh për Kiametin është edhe më vështirë se të flasësh e të zbulosh misteret e vdekjes. "Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë." (Kuran, 7/ 187) Për Kiametin mund të tregohet vetëm aq sa vetë Krijuesi ka dashur të na zbulojë nëpërmjet shpalljes kuranore. Ngjarja e madhe dhe tronditëse është atribut vetëm i Allahut. "I Lartësuar qoftë Ai, që vetëm i Tij është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe ç'ka ka ndërmjet tyre dhe, vetëm Ai di për momentin e Kiametit dhe te Ai ktheheni." (Kuran, 43/ 85) "Thuaj: "Unë nuk e di a do të jetë afër ajo që u premtohet, apo Zoti im do ta vonojë atë shumë! Ai është që e di të fshehtën, por fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt..." (Kuran, 72/ 25-26)

Ja, kështu e udhëzonte Allahu të Dërguarin e Tij, Muhamedin, që t'u përgjigjej shqetësimeve të brendshme njerëzore.

Hatixhja

MODELI I GRUAS MYSLIMANE

Karakterit dhe mbështetja ndaj Profetit

Bashkëshortja e Profetit, shoqja e jetës dhe e ditëve të tij më të vështira, ishte një grua e bukur dhe me moral të lartë, e cila rridhte nga një familje e respektuar, me tradita dhe njohuri fetare. Ajo njihej për karakterin e saj të fortë, ndershmërinë dhe drejtësinë, virtyte këto të cilat e bënë të respektuar në Mekën e asaj kohe.

Duke qenë një nga personazhet më dinamike dhe vitale të historisë islame, jeta e pashembullt e Hatixhes, ka qenë një burim frymëzimi dhe inkurajimi, duke luajtur një rol model, për të gjithë ata që aspirojnë një shërbim aktiv, me jetën dhe pasurinë e tyre, në rrugën e Allahut dhe të Profetit a.s. Jeta e saj përbën një shembull me ato që arriti si grua, megjithëse jetoi në një kohë kur të qenët grua ishte një disavantazh dhe mangësi. Hatixhja është një ndër katër gratë më të mira në historinë e njerëzimit, krahas Mejremes, nënës së Isait a.s., Asijes, gruas së

faraonit, dhe Fatimes, vajzës së Profetit, fakt ky të cilin e ka pranuar vetë Profeti Ynë.

Në Mekë, ku besimi, sakrifica dhe trimëria ishin aq të nevojshme, Allahu i dha Profetit Hatixhen. Ajo ishte asokohe ndoshta gruaja më e guximshme e Mekës, e cila i siguroi mbështetje të palëkundur të Dërguarit të Allahut, gjatë ditëve më të vështira, kur problemet ishin në kulmin e tyre, dhe pasonin njëritjetrit. Hatixhja ishte myslimania e parë, që besoi në të Dërguarin e Zotit, kur ai kishte më shumë nevojë për të, dhe kjo nënkuptonte se ajo zinte një vend të veçantë të Profeti ynë.

Hatixhja ishte e dashura e rinisë së tij, këshilltarja dhe partnerja e tij besnike, përgjatë pesëmbëdhjetë viteve që ata kaluan së bashku përpara shpalljes apo dhe në mjedisin kaotik të shpalljeve të para, si një grua e fortë dhe e palëkundur. Kur ai filloi të thërriste njerëzit në Islam, ajo u bë përkrahësja e tij më e madhe, si materialisht ashtu dhe shpirtërisht.



Kur sulmet e idhujtarëve bëheshin të padurueshme ai gjente prehjen pranë saj dhe kur ata e kërcënuan me jetë, ai gjeti tek ajo siguri. Si në fjalën ashtu dhe në heshtjen e saj fshihej dituria. Në ngazëllimin e saj mund të dalloje kurajë dhe forcë.

Si bashkëshorte e robit më të dashur të Allahut, ajo do të merrte titullin “nëna e besimtarëve”, një titull i dhënë nga Zoti i Plotfuqishëm.

Mbështetja ndaj Profetit tonë duket qartë edhe në fjalët e saj: “Mos u frikëso! Allahu padyshim do të të mbrojë. Ti je i tillë që ruan lidhjet farefisnore, ndihmon të dobët dhe ushqen të varfrit. Ti je gjithmonë mikpritës me mysafirin. Ti vazhdimisht kërkon të vërtetën, duke iu përkushtuar rrugës së drejtë...” si dhe “Me siguri që Allahu nuk do të të braktisë ty dhe nuk do të lejojë që asgjë e keqe të të ndodhë, sepse në çdo fjalë, ti thua të vërtetën, je i besueshëm me gjithçka që të besohet ty dhe ti je që kujdesesh për ata që ke nën mbikëqyrje”, fjalë këto të cilat do t’i jepnin një kurajë të madhe Profetit të Dhembshurisë.

Shpenzimi i pasurisë në rrugën e Allahut

Hatixhja ishte e pasur, por pasuria nuk mund të sigurojë paqe, as nuk mund të përmbushë nevojat shpirtërore të njeriut. Ajo merr vlerë kur fitohet dhe shpenzohet për një qëllim të denjë dhe, për më tepër, në këtë mënyrë, kthehet në një thesar të përjetshëm që ndriçon botën e përtejme. Për këtë, Hatixhja donte që jeta dhe pasuria e saj të bëheshin të përjetshme, duke i përdorur ato në shërbim të Profetit dhe kauzës së tij.

Ajo la mënjatë të gjitha dëshirat personale dhe punoi ditë e natë për ta ndihmuar profetin në përhapjen e mesazhit islam dhe do të trokiste shumë herë, derë më derë, duke shpresuar se të paktën një zemër më shumë, do të shijonte besimin. Ajo u zgjati dorën atyre që kishin nevojë dhe sakrifikoi të gjithë pasurinë e

saj në rrugën e Allahut, në mënyrë që zemra të tjera të mbusheshin me bukurinë e besimit.

Vetëm disa vite pasi kishte ardhur Shpallja në shpellën Hira, Hatixhja nuk kishte më asgjë nga pasuria e saj dhe ishte në gjendje nevojë. Nëse do të kishte dashur, do të kishte pasur një jetë të rehatshme, në vend të vuajtjes së agonisë. Ajo kishte një karakter dhe besim aq të fortë, sa që nuk do ta linte në baltë atë të cilin e kishte besuar si profet, që ditën e parë të profetësisë. Ashtu siç kishte kaluar ditë të bukura me të, ashtu do të kalonte edhe të hidhurat. Kështu që ajo zgjodhi urinë dhe etjen mbi shtratin e ngrohtë të shtëpisë në Mekë, në kohën kur Profeti do të kishte më shumë se kurrë nevojë për të.

Shtrati i saj vdekjes nuk ishte tjetër veçse një dyshek i improvizuar në një tendë.

Shenjat e ndarjes kishin mbërritur. Tashmë ishte koha të shkonte në botën e përtejme, në krahët e këtij burri për të cilin kishte sakrifikuar gjithë pasurinë dhe jetën e saj. Një jetë që filloi në natën e Kadrit, gjithashtu u mbyll po në natën e Kadrit, në moshën 65 vjeçare.

Ky ishte fundi i vuajtjeve me uri dhe dhimbje për Hatixhen. Ajo kishte qenë një nga gratë më të pasura të Mekës dhe po largohej në botën tjetër si një grua në mërgim dhe mes një bashkësie të uriturish. Do të largohej me trup, por zemra dhe shpirti i saj ishin me Profetin dhe jetimët që po linte nën kujdesin e tij. Ajo kishte lindur shpejt, ishte prezantuar shpejt me të vërtetën dhe tani po ikte shpejt.

Dashuria e Profetit për Hatixhen

I Dërguari i Allahut nuk e harroi kurrë Hatixhen me të cilën ai kaloi ditët më të trazuara. Dashuria dhe besnikëria e tij për të vazhduan deri në vdekje. Në çdo rast që i jepej, Profeti e kthente bisedën nga Hatixhja, madje edhe gjatë momenteve kritike.

Hatixhja kishte lënë një përshtypje

dhe paqe aq të madhe në zemrën e bashkëshortit të saj, saqë ai i vizitonte shpesh të afërmit dhe miqtë e saj të vjetër dhe përpiquej të mbante gjallë kujtimin e saj. Askush nuk mund të zinte vendin e kësaj gruaje të paarritshme, e cila përveçse ishte ndër të parat pioniere të besimit, qëndroi patundshmërisht besnike deri në ditën që do të ndërronte jetë. E si mund të harrohej një besnikëri e tillë?

Kur i vinte ndonjë dhuratë, Profeti do t'ia dërgonte së pari të afërmve të Hatixhes. Ai i nderonte dhe tregonte shumë respekt për ta, duke iu dhënë madje edhe jastëkun në të cilin ulej. Kur dikush e pyeti për këtë sjellje, ai tha: "Unë i dua ata të cilët i ka dashur edhe ajo".

Në vitet e mëvonshme Profeti shkonte shpesh të vizitonte varrin e gruas së tij të dashur dhe lutej për një kohë të gjatë mbi të.

Hatixhja u njoh nga umeti i Profeti Muhamed a.s., për shkak të kureshtjes së Aishes, pasi ishte ajo e cila pyeste vazhdimisht për të. Pyetjes së saj, se cila është arsyeja e vëmendjes së Profetit për këtë grua, Krenaria e Njerëzimit do t'i përgjigjej: "A ka pasur ndonjë tjetër si ajo? Beto hem në Allah se Ai kurrë nuk më ka dhënë ndonjë më të mirë se ajo! Kur njerëzit ngulnin këmbë në mosbesim, ajo erdhi te unë dhe besoi. Kur njerëzit më akuzuan për gënjeshtar, ajo konfirmoi ato që unë thosha. Kur njerëzit m'i morën pronat, ajo më solli gjithçka kishte dhe m'i fali mua. Dhe Allahu nuk më dha fëmijë me asnjërin përveç saj."

Vite më vonë, Aishja, një tjetër shembull i besnikërisë, tregonte se i Dërguari i Allahut e përmendte aq shpesh dhe fliste për të kaherë me dashuri dhe admirim. "Megjithëse nuk e kam takuar kurrë, nuk kam qenë asnjëherë aq xheloze për ndjenjat e Profetit kundrejt një gruaje tjetër siç jam ndjerë për Hatixhen. Ai e përmend shpesh atë dhe e mban në konsideratë aq të lartë, saqë sa herë që ther ndonjë bagëti dhe e ndan, i dërgon të

afërmve të Hatixhes pjesën e tyre", – do të thoshte Aishja.

Kështu pra, Hatixhja zinte një vend të veçantë në krah të të Dërguarit të Allahut. Zoti e bekoj atë me një lloj dashurie, të cilën asnjëra nuk mundi ta fitonte kurrë. Veprimet e tij ndaj bashkëshortes, ishin një përmendore besnikërie.

Të gjitha këto cilësi dhe virtyte që, për fat të keq, nuk i gjen as sot ndër njerëz, e jo më në kohën e injorancës, e bënë atë më të dashurën për Profetin, njëkohësisht modelin dhe shembullin më të shkëlqyer të femrës si nënë dhe si bashkëshorte; modelin e gruas së moralshme, të virtytshme, të guximshme dhe të zgjuar, model të cilin të gjitha ne, duhet ta ndjekim.

Kjo ishte Hatixhja dhe jeta e saj e pashembullt, vendi i saj tek Allahu dhe Profeti është më se i qartë, por këtë vend ajo e fitoi, nuk iu dhurua. Padyshim se askush nuk mund të arrijë fitore të tilla pa kaluar pengesat dhe sprovat që mund të sjellë jeta.

Njerëzit fitojnë merita përmes sakrificave që bëjnë. Ata tregojnë ngjyrat e tyre të vërteta në përballje me fatkeqësinë, në kurajën dhe vendosmërinë për të vazhduar përpara pa u lëkundur.

Çdo kohë e vështirë gjatë historisë ka prodhuar heronjtë e vet e Hatixhja ishte një nga heronjtë e ditëve të para të Islamit, por edhe sot, ajo është një heroinë, për vetë modelin që la pas, duke arritur majat e virtytit dhe fisnikërisë në shpirt.

Askush nuk mund të krahasohej me të në bujari dhe bamirësi. Sa njerëz të pasur janë gati sot të japin çdo gjë të tyre në rrugën e Allahut deri në pikën ku të vuajnë vetë për bukën e gojës? A ka qëndruar dikush ndonjëherë më lart se Hatixhja? A ka parë bota të ngjashme me të? Historia tregon se përgjigja është JO.

Zoti e zgjodhi atë si myslimanen e parë; e zgjodhi si bashkëshorten ideale të Profetit të mbarë njerëzimit; e zgjodhi si model të gruas në Islam.

Vrimat e zeza **NË ORGANIZIMIN ISLAM**



Xhamitë e periudhës osmane të ndërtuara kudo në botë, por edhe tek ne, janë një kujtim i bukur i një periudhe të rëndësishme të progresit të nisur nga mendjet ambicioze dhe entuziaste të myslimanëve të asaj kohe.

Duke marrë parasysh funksionin e tyre, me objektet përcjellëse të inkorporuara bukur (medrese, musafirhane, konaqe, mejtepe) me përbërje të pasur, me një arkitekturë mahnitëse, mund të themi me plot të drejtë se ato objekte kanë qenë sensacion dhe simbol i prosperitetit kohor.

Duke vështruar p.sh. eksterierin e Xhamisë së Hadumit, këtë godinë madhështore arkitektonike me dimensione të mëdha, njeriu ndien një refleks të qetësisë, bukurisë dhe rahatisë shpirtërore.

Psikologjia moderne na mëson që njeriu së bashku me qëndrimet e tij, traditat, e formon edhe mjedisin përreth.

Xhamia apo mesxhidi është i menduar si pikë qendrore ku bashkohen myslimanët, e që është edhe kuptimi literar (arab. - xhami) me qëllim të organizimit, edukimit, lutjes dhe punës ekipore. Ekipi, apo grupi ekipor sipas definicionit është një grup njerëzish i cili takohet rregullisht, konsultohet reciprokisht, e njeh bukur detyrën, kryen ndarjen e rregullt të detyrave dhe në mënyrë të sinkronizuar synon të arrijë qëllimet afatshkurtëra dhe afatgjata duke dhënë secili individ mundin maksimal.

Shembulli më i mirë i këtyre ekipëve të xhematit janë ekipet sportive.

Xhamitë që në brendinë e tyre kishin xhemate apo ekipe të tilla kanë qenë fanarë të aftë që të akumulojnë sasi të mjaftueshme të erës në gjiun e tyre duke udhëhequr shoqëri të tëra myslimane në ardhmëri të shkëlqyer.

Por ajo që sot kemi në shumicën e xhamive në tërë botën islame mund ta përshkruajmë me fjalën grumbull (grup). Ndërsa grumbulli, sipas definicionit, është një grup njerëzish i afërt në një hapësirë të caktuar, në afat të caktuar kohor, me një interaksion sipërfaqësor, me një rrjedhë njëkahëshe të informatave, pa kurrfarë ndarjeje të punës dhe me një lidhje të pamjaftueshme ndërmjet tyre. Shembulli i këtyre grumbujve mund ta shohim p.sh. në aeroplanë, në teatër, tramvaj, autobus, tren etj.

Duke vështruar nga ky kënd nuk ka fare ndryshim në mes grupit i cili për çdo të premtë kalon gjysmë ore në xhami duke dëgjuar një ligjëratë të mërzitshme dhe uniforme të ligjëruarit dhe grumbullit të njerëzve i cili udhëton me tramvaj prej një vendi në një vend tjetër duke dëgjuar një përmbajtje edukative të

caktuar nga radioja, duke jetuar në iluzion se ky grumbull punon diç të dobishme.

Xhamitë me këtë mentalitet dhe praktikë janë "kasaphanë" potenciale ose dhoma të gazeve për të ngulfatur çdo iniciativë apo vrima të zeza të cilat në kreativitet të avangardës së re janë të ndërtuara në frikë dhe padituri të liderëve.

Liderët e vërtetë krijojnë që në fillim njerëz – gjegjësisht liderë të vërtetë potencialë.

Pejgamberi, a.s., është shembulli më i mirë për këtë, i cili në haxhin lamtumirës para turmës të njëqindmijë njerëzve haptas dhe drejtpërdrejt kërkoi informatën kthyesë nga auditoriumi i shumtë me pyetjen: "...A ju komunikova Shpalljen?", duke dëshiruar mendimin, komentën apo mospajtimin eventual pas së cilës pasoi përgjigjja vërtetuese. Vallë, a ka diku në ndonjë vend, shtet islam apo më gjerë që imami pas hutbes së xhumasë, para se të zbresë nga mimberi, të kërkojë mendimin apo informatën pohuese nga auditoriumi?

Xhamitë e kohëve tona janë bërë teatro pa repertuar të mirëfilltë, me paraqitjen amatoreske të imamëve të cilët janë në trendin e thellë të paarsimit.

Xhamitë zakonisht i vizitojnë pleqtë në prag të fundit të jetës së tyre, pa vizion dhe plan, me një refleks indiferent.

Myslimanët potencialë, të caktuar me intelekt kritik, ose heshtin ose nuk vijnë në xhami, për të mos i identifikuar me arkitekturën e xhamive.

Pyetjet që paraqiten para nesh:

1. A kërkon shëkulli 21 një arkitekturë më atraktive dhe më të freskët e cila sipas funksionit do t'i përgjigjet nxitjeve teknologjike të kohës e cila vjen?

2. Si ti bëjmë xhamitë si potencial për ardhmërinë e avangardës rinore?

3. Si ta formojmë frymën ekipore të xhematit, e jo të jemi grup apo masë e paorganizuar, pa planprogram dhe detyra e obligime?

4. Cilat janë ato programe, faktorë argëtues dhe elemente motivuese që xhamisë do t'i kthejnë epitetin e saj nga e kaluara - busulle e shoqërisë myslimane?

5. Përse askush nga ju nuk pyet asgjë ditën e xhumasë, pas hutbes?

Po cila është zgjidhja atëherë?

NUK MË SHKON NDËRMEND TË MENDOJ
NË VENDIN TUAJ!

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi



HAFIZ MUSTAFA DORACI

(1894-1972)

Lindi në Tiranë në vitin 1894 në një familje me tradita patriotike e fetare. I ati i tij Hafiz Haxhi Mehmeti e dërgon që në moshën 7 vjeçare në Stamboll te djali më i madh, për të vazhduar studimet e plota. Vitet që kaloi në Stamboll ishin nga më të rëndësishmet në formimin e tij kulturor-fetar si dhe dashurinë për atdheun. Larg atdheut përjetoi shpalljen e pavarësisë së vendit më 28 nëntor 1912, Luftën e Parë Botërore 1914-1918.

Ish kryetari i Komunitetit Mysliman, Hafiz Musa Basha, bashkëkohës i studimeve me Hafiz Mustafa Doracin në Stamboll tregon: "Hafiz Mustafa Doraci ka qenë nxënës i shkëlqyer e mori titullin "Hafiz", dhe ka shërbyer në xhamitë kryesore të Turqisë si: Sulltan Fatihut, Sulltan Selimit, Mahmut Pashës e Haxhi Pashës."

Në vitin 1923 në Shqipëri ndodhën ngjarje të reja. Kongresi Islam Shqiptar zhvilloi punimet, të cilat çuan në pavarësinë nga Stambolli. Shaban Sinani në gazetën "Drita Islame" Nr. 17 datë 14.09.1998 shkruan: "Kongresi u zhvillua me lejen e autoriteteve shtetërore dhe nën kujdesin e gjyqit të lartë të shariatit vendas. Të 36 delegatët e Kongresit që përfaqësonin prefekturat dhe nënprefekturat e Shqipërisë kërkohesh që të ishin myslimanë të devotshëm shqiptarë dhe të zotëronin mirë gjuhën shqipe në të folur e në të shkruar".

Punimet e Kongresit i drejtoi dijetari i mirënjohur Haxhi Vehbi Dibra (Agolli), u shkëputën lidhjet me Shejhul-Islamin e Turqisë dhe menjëherë Hafiz Mustafa Doraci kthehet në Shqipëri.

Më datë 10.01.1925 emërohet imam në xhaminë e Met Fires. Në dekretin e emërimit (Beraet) thuhet: "Pra, ju porosisim që të vazhdoni rregullisht në detyrën e shenjtë që ju është ngarkuar dhe të jeni larg prej atyre sendeve të liga që ju ndalon sheriatit, të silleni mirë, me veti të bukura që na urdhëron Pejgamberi Alejhis-Salam, dhe ta dini se përndryshe kjo detyrë ju hiqet e i jepet atij që e meriton. Shpëtimi e lumturia në të dy jetët, qoftë mbi ata që veprojnë e gjenden gjithmonë në rrugë të Zotit".

Në detyrën e imamatit fitoi zemrat e besimtarëve. Me sjelljen e diturinë e tij, veçanërisht në këndimin e Kur'anit me

ndjenjë të thellë, bukur e saktë, prekte thellë shpirtat e dëgjuesve. Në vitin 1927 emërohet mësues Kur'ani në Medresenë e Tiranës. Por në vitin 1928 i ngarkojnë dhe detyrën e Hatibit në xhaminë e Met Fires siç thuhet: "Zotit Hafiz Mustafa Doraci në Tiranë. Pas propozimit të zyrës së Vakëfit Tiranë unë, Kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit, e ju mbështes propozimit me Nr. 44/1 datë 02.05.1928 të zyrës së shariatit në Tiranë, Dekretoj emërimin e Zotnisë tuaj edhe si Hatib në xhaminë e Met Fires".

Hafiz Doraci ishte teologu më i ngarkuar me detyra fetare, veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit dy herë në ditë bënte mukabele në xhamitë e Et'hem Beut dhe Stërmasit siç konfirmohet në "Zani i Naltë" Nr. 10-11, 1938, f. 350-351. Me ardhjen e pushtetit komunist në vitin 1944 Medreseja e Tiranës vazhdon por me një program më të shkurtuar. Në vitin 1956 Kryesia e Komunitetit Mysliman Shqiptar shpall dekretin me Nr. 30 ku thuhej: "Zotit Hafiz Mustafa Doraci. Me vendim Nr. 55 datë 23.05.1956 të Këshillit të përhershëm të Komunitetit Mysliman, dekretin emërimin tuaj mësues Kur'ani dhe imam në xhaminë e Met Fires".

Në librezën e punës së tij, faqe 6 thuhet: "Shënime mbi fillimin, transferimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve në punë të nënshkruar nga data 01.06.1936 deri më 01.09.1964 Nr. 35 regjistri themeltar. Vazhdoi të dy detyrat me devotshmëri, por lufta radikale e pushtetit komunist kundër fesë në vitin 1967 bëri që të shkatërrohen të gjitha institucionet fetare dhe me një komunikim të Komunitetit Mysliman të datës 18.02.1967 njoftohej vendimi në të cilin thuhej që: "Klerikët të mos vishnin uniformën fetare. Ata ndaloheshin kategorikisht të kryenin shërbesa fetare në xhami apo shtëpi, thirrjen e ezanit në minare ditën e xhuma".

Hafiz Doraci mbeti i mbyllur në shtëpi, i brengosur thellë në shpirt kur përpara syve ia shembën minaren e xhamisë. E thirrën të flasë kundër fesë, por nuk pranoi, madje e kërcënuan me burg e sërish nuk pranoi, ia ndaluan pensionin që merrte e në varfëri jetoi derisa ndërroi jetë në vitin 1972. Hafiz Mustafa Doraci mbetet një ndër figurat më në zë të Hafizit, imamatit, predikuesit, pedagogut, që edukoi breza të tërë besimtarësh e nxënësish.



XHAMIA

elinie



Kulmi i arkitekturës klasike osmane u arrit në ndërtimin e xhamisë së sulltan Selimit II në Edirne, kryeqyteti i dytë i Perandorisë Osmane.

Kjo xhami u projektua dhe u ndërtua nga kryearkitekti i perandorisë, Mimar Sinani. Ky arkitekt i famshëm, i cilësuar si një nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave, e ngriti këtë kompleks të mrekullueshëm, kur ishte mbi 70 vjeç, gjatë viteve 1569-1575, dhe deri në ditën e vdekjes e konsideroi kryeveprën e tij, më madhështore se xhamia "Sulejmanie" e Stambollit.

Ky kompleks xhami, me avlli të dyfishtë, ka dy oborre kënddrejtë me dimensione 64 x 44 m. Xhamia është e pajisur me katër minare, të larta mbi 70 m, më të lartat në gjithë botën islame. Çdo minare ka nga tri ballkone (kazanë, sarefe). Këto minare, që simbolizojnë fuqinë e fjalës, janë elegante dhe punuar me shumë finesë.

Kupola madhështore ka një diametër 31.6 dhe lartësi mbi 54 m. Për dimensione, largësi dhe elegancë elektronike kjo kupolë e mrekullueshme duket sikur celebron unitetin e perandorisë së sulltan Selimit II dhe lëshohet në drejtim të pikave të horizontit. Kupola, pra, simbolizon bashkimin e besimtarëve.

Mihrabi është prej mermeri, ashtu edhe minberi që ndoshta është më i bukuri i gjithë Turqisë me anët e tij të gdhendura e të shpuara me finesë së azhur. Kamarja e mihrabit është e veshur e gjitha me pllaka majolike të mrekullueshme të Iznikut, sipër të cilave spikasin mbishkrime kaligrafike kuranore, me shkronja elegante të bardha mbi një sfond të kaltër. Dhe lozha perandorake që gjendet në këndin jug-perëndimor është zbukuruar madhërisht me pllaka majolike të mahnitshme. Çezma për abdes gjendet në qendër të oborrit të nderit, rezervuar atëherë për procesione perandorake. Tribuna e myezinit gjendet në mes të sallës së faljes dhe përbëhet nga një platformë e mbajtur në

kolona kënddrejta që qëndrojnë mbi një shtresë mermeri në mes të shatërvanit të mrekullueshëm.

Medreseja është ngritur në këndin jug-lindje të oborrit, ndërsa shkolla e lartë (Darul Hadith) në këndin jug-perëndimor. Këndi perëndimor është zënë plotësisht nga një galeri tregtie (Kavaflar Arasta) që përbëhet nga 124 dyqane, ku një kohë punonin fabrikuesit e këpucëve.


Sot medreseja strehon muzetë arkeologjikë dhe etnografikë, ndërsa shkolla e lartë kuranore është muzeu i arteve turke islame.

Në koleksionin etnografik janë ekspozuar qëndisje osmane, qilima, armë të vjetra, monedha, veshje të mrekullueshme osmane dhe pajisje shtëpie. Koleksioni arkeologjik ekspozon xhevahire të ndryshme të vjetra, qeramika, enë balte të pjekur, monedha, skulptura e fragmente arkitektonike.

Në shkollën e lartë kuranore janë ekspozuar mbishkrime monumentesh osmane të shembur, pajisje kuzhine, panele qeramike, kopje dorëshkrimesh të Kur'anit, qëndisje, armë të vjetra dhe xhama, të gjitha të epokës osmane. Këtu mund të admirosh edhe disa pajisje që një kohë i përkisnin teqesë së dervishëve mevlevi si: medaljon, kupa ilaçesh kuruese, mbishkrime të realizuar nga dervishë kaligrafë të shquar, etj. Në kopshtin e muzeut të arteve turko-islamike, në qendër të oborrit gjenden gurë varresh të vjetër osmanë.

Sinani i madh, në mes qindra objektesh ndërtuar prej tij, xhaminë "Selimie" në Edirne e mbante mbi të gjitha dhe për kupolën madhështore ka thënë: "Arkitektët më në zë të vendeve të krishtera perëndimore thonë se arkitektët osmanë nuk kanë ndërtuar asgjë të krahasueshme me kupolën e Aja Sofis (Shën Sofisë). Me ndihmën e të Plotfuqishmit dhe përkrahjen e sulltanit, arrita të ndërtoj për Selimien një kupolë që e kalon katër pëllëmbë në diametër dhe gjashtë pëllëmbë në lartësi atë të Aja Sofisë"

PESHA E *lyalës*



Fjalët kanë shpirt , mbartin një shpresë të fshehtë. Fjalët kanë ngjyrë, një harmoni të mekullueshme mes tyre. Depërtojnë nga zemra në zemër, nga njeriu në njeri dhe nga një botë në tjetrën. Lënë gjurmët në zemër, kohë dhe vend.

Është shumë e çuditshme sesi çdo njeri nxjerr fjalë të ndryshme të cilat pasqyrohen në pamjen e tij të jashtme. Fjalët tona janë pamja, shpirti dhe pasqyra jonë. Janë pasqyrueset dhe shpjegueset tona më të mira. Një gjuhë është një njeri dhe një njeri mund të shprehë një botë të tërë. Gjuha bën njeriun dhe njeriu dashurohet nën hijen e fjalëve. Nën këtë hije thuren lidhjet më të forta.

Fjalët lënë gjurmë, ka fjalë të hidhura dhe therëse, të plagosin fshehurazi pa u ndjerë. Edhe nëse plaga mbyllet gjurmët e saj të hidhura ngelen me ty.

Ka raste kur fjalët janë përkujtuese të diçkaje, i përkasin një kohe apo asnjë lloj kohe. Ato thjesht qëndrojnë në jetën, kujtesën dhe thellësitë e zemrës sonë...

Fshehur mbajmë shumë fjalë, fjalë ndaj të cilave kemi thurur mure ndarëse, kemi vendosur perde të errëta , mbyllur dritaret dhe dyert, fjalë të cilat nuk kemi dëshirë t'i kujtojmë. Fjalët që sjellin humbje dhe dhimbje mbulohen me një mbulesë të zezë për të mos u hapur më kurrë.

Njeriu fshihet në fjalët e zemrës, ai pasqyrohet në gjuhën e fjalëve. Njohuritë, formimi , dashuria, respekti, toleranca, edukata, mangësitë, dorëzimi, qëndrimi , shpirti dhe karakteri i njeriut kuptohen me anë të fjalëve. Dhe njeriu dashur pa dashur e shpalos veten e tij nëpërmjet fjalëve.

Zoti i madhëruar e ka pajisur njeriun me aftësi të panumërta dhe nga më të ndryshmet. Padyshim që gjuha dhe aftësia e të folurit është vetëm një nga mirësitë e dhuruara nga Zoti (xh.sh.).

Ne Kuranin famëlartë, në shumë vende na është treguar se si duhet të tregohemi të kujdesshëm me fjalët:

"Mendo para se të flasësh." (Muminun, 3)

"Fol me butësi." (Bekara, 83)

"Mos thuaj gënjeshtër." (Hac Suresi, 30.)

"Thuaj të vërtetën." (Al-i Imran, 17.)

"Fol me delikatesë." (Isra, 13)

"Peshoji mire fjalët." (Isra, 28)

Mënyra e të folurit e njeriut merr formë sipas edukatës dhe zgjuarsisë së tij. Thënë ndryshe ç'ka mendja përmend gjuha. Gjuha është pasqyrimi më i kulluar dhe i pa të meta i njeriut. Zemra e njeriut fshihet pas fjalëve të tij.

Njeriu është përgjegjës për fjalët e nxjerra nga goja sepse ato fjalë i drejtohen dikujt apo diçkaje. Ato i ngjasojnë pak a shumë kohës, fjalët e thëna nuk kthehen më mbrapsht dhe nuk zhduken. Ndryshimi apo përmirësimi i fjalëve të thëna me qëllim apo pa qëllim kërkon një kohë të gjatë. Gjurmët e fjalëve të thëna qëndrojnë mbi miqësitë e prishura, zemrat e thyera dhe lidhjet e këputura.

Një fjalë mund të ndryshojë një njeri, një kohë , një jetë dhe ndoshta gjithë botën. Mund të zhysë në errësirë dy botë mund t'i ndajë ose krejt e kundërta mund t'i ndriçojë dhe stëllë qetësinë e shumëpritur. Kemi dhe fjalë të mira , shëruese , shpëtuese , lehtësuese , shpresëdhënëse dhe paralajmëruese të pranverave të përjetshme. Ne mund të lexojmë faqet e ndryshme të një libri por vetëm një rresht mund të bëhet shkak i ndriçimit tonë shpirtëror.

Ndonjëherë me anë të fjalëve të sinqerta, plot dashuri e përkushtim mund t'i tregojmë njerëzve për ekzistencën e një bote krejtësisht ndryshe nga kjo e jona. Mund ta shikonë jetën nga një dritare e paparë më parë.

Ka fjalë të ngjashme me të bardhën, rrezatuese si një yll, shëruese e plot dhembshuri. Ka fjalë të fshehura pas kaltërsisë qiellore, si të ishin porosi të qiellit. E kaltra është mrekullia e shpresës , shpresa një pike vese e zemrës, një pranverë e shpirtit.

Fjalët janë si pasqyra, ndonjëherë të thyejnë dhe lëndojnë por mos harrojmë se fjalët edhe shërojnë plagët e mëparshme, sjellin pranverën në shpirtat tanë.





Shërimi ME ERËZAT

Erëzat, të përdorura përgjithësisht për aromatizimin e ushqimeve, mund të përdoren gjithashtu për të vrarë mikrobet. Në këto kohë kur njerëzit po zgjedhin gjithnjë e më shumë ushqime që janë më pak të përpunuara, madje mund të mos përmbajnë aditivë kimikë, vlera mbrojtëse e erëzave është rritur. Përveç kësaj, përdorimi i erëzave në ushqime është bërë më i përhapur falë hulumtimeve për përfitimet e ndryshme të tyre.

Për breza të tërë, erëzat janë përdorur për të trajtuar

çrregullime të ndryshme. Hulumtimet shkencore tregojnë se shumica e erëzave kanë veti medicinale që ose lehtësojnë simptomat e sëmundjeve ose parandalojnë shfaqjen e tyre. Një veti e tillë lidhet me mënyrën se si erëzat janë efektive kundër formimit të biofilmave.

Erëzat luftojnë biofilmat

Një biofilm është një mikro-ekosistem i krijuar për specie të ndryshme mikrobike që i mbron ato nga faktorët mjedisorë, duke i lejuar ata të qëndrojnë në një mjedis

të përshtatshëm. Biofilmat janë agregate të heshtur të mikroorganizmave, në të cilat mikrobet janë të ngulitura në një substancë polimerike jashtëqelizore. Prandaj, ato shfaqin shkallë të lartë të rezistencës ndaj antibiotikëve dhe substancave antimikrobike. Pothuajse të gjitha llojet e mikroorganizmave duket se formojnë grupe biofilmash, si në sipërfaqe biologjike ashtu edhe në ato jobiologjike. Me rritjen e incidencës së infeksioneve të implikuara me biofilm, kërkimi për kontrollin dhe parandalimin e formimit të biofilmit ka marrë gjithashtu vull. Disa lloje të bakteve që mund të zhvillohen në biofilma përfshijnë *Pseudomonas*, *Enterobacter*, *Flavobacterium*, *Alcaligenes*, *Staphylococcus* dhe *Bacillus*. Formimi i biofilmit ndodh në tre faza: ngjitja e bakteve në një sipërfaqe, kolonizimi përmes riprodhimit në sipërfaqe dhe zhvillimi i matricave të pakthyeshme ekzopolisakaride.

Për shkak se formimi i biofilmit mund të nxitet nga disa antibiotikë, shumë studiuues kanë filluar të hetojnë vetitë antimikrobike dhe anti-biofilm të substancave të ndryshme natyrore.

Efikasiteti i erëzave të përdorura zakonisht për të parandaluar formimin e biofilmit është i një rëndësie të madhe. Shumë erëza veprojnë si agjentë natyralë antimikrobikë me veti të larta anti-biofilmike. Studimet kanë treguar se xhenxhefli, kurkumina, kanella dhe piperi i zi, të cilat përdoren gjerësisht veçanërisht në shumë vende aziatike, kanë veti antimikrobike dhe anti-biofilmike. Ndërveprimi midis disa prej erëzave, i cili shkakton deformime në formacionet e biofilmave, është gjithashtu i rëndësishëm. Me rritjen e ndërveprimit midis erëzave, rritet edhe kapaciteti i tyre për të izoluar formimin e biofilmit. Disa erëza izolojnë mikroorganizmat duke i penguar ata të ngjiten në një sipërfaqe ose me njëri-tjetrin.

Së bashku me vetitë e tij anti-inflamatore (parandalimi i inflamacionit), antioksidant (ngadalësimi i reagimit të vajrave me oksigjen), anti-angiogjenezë (frenimi i formimit të enëve të reja në mënyrë që tumori të mos përhapet), anti-aterosklerozë dhe parandalues të kancerit, xhenxhefli ka edhe veti antimikrobike. Kështu, përdorimi i tij në trajtimin e infeksioneve bakteriale është bërë i përhapur. Është përcaktuar gjithashtu të jetë një stimulues i tretjes.

Shafrani i Indisë, veçanërisht përbërësi kryesor i tij kurkumina, ka një gamë të gjerë të vetive farmakologjike, duke përfshirë ato anti-mikrobike, antidiabetike, anti-inflamatore, antioksidante dhe antikancerogjene (parandaluese të kancerit). Mund të parandalojë disa baktere nga formimi i biofilmit. Dihet se kurkumina redukton shfaqjen e sëmundjeve të tilla si skleroza e shumëfishtë (MS), sëmundja e Alzheimerit dhe sëmundja e Parkinsonit.

Kanella, një tjetër barishte medicinale, përdoret zakonisht në kozmetikë si dhe në produkte ushqimore. Sipas mjekësisë tradicionale kineze, kanella është përdorur si një agjent shërues në rast të demtimit të nervave. Një studim klinik i vitit 2004 zbuloi se kanella mund të jetë një trajtim efektiv i diabetit: ajo uli shkallën e sheqerit esëll në gjak të me 18-30%. Edhe pse nuk janë arritur përfundime të caktuara në lidhje me efektin e kanellës si një trajtim antidiabetik, është zbuluar se ka potencial për të ulur nivelet e sheqerit në gjak edhe pas ngrënies. Me vetitë e saj antimikrobike, kanella vepron si një agjent antibakterial

dhe përdoret kundër inflamacionit. Përveç kësaj, dihet se ka efekte të dobishme në shëndetin oral. Është përdorur për të trajtuar dhimbjet e dhëmbëve, infeksionet e gojës dhe erën e keqe të gojës.

Piperi i zi është një tjetër erëzë e përdorur gjerësisht në mjekësinë popullore. Piperina, një përbërës i rëndësishëm alkaloid në piperin e zi, shfaq një efekt parandalues për disa lloje kanceresh, veçanërisht kancerin e gjirit, prostatës dhe zorrës së trashë. U zbulua se piperina frenon disa nga proteinat e prodhuara nga qelizat e tumorit duke ndërhyrë në mekanizmat e tyre të sinjalizimit, duke reduktuar kështu përparimin e tumorit. Në studimet në lidhje me përdorimin e piperit të zi, veçanërisht vajrave esencialë të tij, për trajtimin e diabetit të tipit 2, u vu re se ai frenon dy enzimat që shndërrojnë niseshtën në glukozë. Në këtë mënyrë ndihmon në menaxhimin e sheqerit në gjak dhe vonon përthithjen e glukozës.

Ekspertët që hetojnë shkallën e incidencës së kancerit në mbarë botën përcaktuan se indianët kanë pesë herë më pak gjasa për t'u prekur nga kanceri i gjirit, tetë herë më pak gjasa për t'u prekur nga kanceri i mushkërive, nëntë herë më pak gjasa për t'u prekur nga kanceri i zorrës së trashë dhe pesëdhjetë herë më pak gjasa për t'u prekur nga kanceri i prostatës sesa amerikanët. Këto norma janë të jashtëzakonshme duke pasur parasysh faktin se njerëzit indian janë të ekspozuar ndaj më shumë kancerogjenëve për shkak të kushteve të tyre mjedisore dhe të jetesës. Është vlerësuar se ndryshimi në normat rrjedh nga përdorimi i zakonshëm i erëzave nga indianët. Kështu, janë nisur kërkime të reja që hetojnë këtë temë.

Erëzat janë më efektive kur përdoren së bashku. Për shembull, marrja e kurkuminës në shafran të Indisë së bashku me piperinën në piperin e zi rrit njëzetfish përthithjen e kurkuminës. Njohja se kur duhet t'i përdorni ato për të rritur përthithjen e tyre të tilla si me ushqime të yndyrshme, ose ushqime të nxehta dhe të ftohta gjithashtu rrit efektet e tyre.

Efektet parandaluese ose shëruese ndryshojnë në varësi të rrjedhës së sëmundjes, si dhe sipas mënyrës se si përdoren erëzat. Duhet pasur parasysh se erëzat mund të kenë edhe disa efekte anësore. Disa përfshijnë: probleme me dispepsi për njerëzit me ulçer (të shkaktuara nga marrja e tepërt e piperit të zi), gjakderdhje e tepërt për shkak të salicilateve në xhenxhefil (i njëjti hollues gjaku që përdoret në aspirinë), nauze dhe ankesa gastrointestinale për shkak të konsumit të tepërt të kurkuminës.

Marrëdhëniet midis ushqimit dhe shërimit

Ushqyerja dhe shërimi janë të ndërlidhura në shumë aspekte sipas ligjeve kauzale që vëzhgojmë në krijim. Jeta krijohet nga Zoti "pa perde", d.m.th., pa nevojën e Tij për ndonjë faktor shkakësor. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse ka ndërmjetës shkakësorë që ne përdorim burimi i shërimit, megjithatë për besimtarët është Ai që është burimi i shërimit përfundimtar (Gjithëshërues). Ashtu si ne kërkojmë të kurohemi me erëza në natyrën që Ai krijoi, ne i lutemi Zotit tonë që të jetë marrësi i manifestimeve kuptimplote, të mençura të emrit të Tij, Gjithëshërues. Erëzat janë një shembull i bekimeve të pafundme të dhuruara nga Zoti ynë Gjithëfuqishëm.

E SHKRUARA E MËPASTAJME E DHELPRËS DINAKE

Ishte seç na ishte.

Në Pyllin Dendak, jo shumë larg qytetit, na jetonte një kafshë shumë e zgjuar, dredharake dhe dinake, që nuk e kishte shoqen mbi dhë. Kjo kafshë bukuroshe quhej Dhelpra Dinake.

Pylli Dendak ishte një vend shumë i bukur e i begatë në bimë, kafshë e pasuri të tjera gjithfarësh. Shpendët ishin aq të shumtë, saqë përmbi kurorat vigane të drurëve syri të shihte tufa të tëra që lëviznin pa pushim si një rë e murrme. Po kishte edhe shpendë të tjerë që nuk mund të fluturonin lart, si pulat dhe gjelat, të cilët flinin paqesisht nën tendat vigane të gjetheve, si në shtëpi ëndrrash pa dyer, pa dritare. Pikërisht vezët e freskëta e të shijshme, por edhe vetë mishin e butë të pulave dhe gjelave kishte shumë për zemër Dinakja e famshme e Pyllit Dendak.

Dhelpra Dinake kishte kohë që ndiqej nga rojet e pyllit, ca ketrushë të shpejtë e topolakë, të cilët edhe vetë e kishin shumë frikë atë, por edhe e urrenin skilen e njohur. Ata synonin ta kapnin befasisht në faj; ta zinin me presh në duar, si i thonë fjalës! Asisoj gjyqi do ta dënonte me fakte e prova bindëse skilen mëkatore, pa shpresuar ku të ankohej. Ajo shpesh u kishte shpëtuar prangave dhe burgut, për shkak se rojet ishin ngutur në kapjen në vendin e ngjarjes, por edhe sepse shpesh zgjuarsia e dinakëria e kishin nxjerrë të pafaj. Kështu deri atë ditë, Dhelpra Dinake e kishte hedhur lumin pa u lagur fare.

Më në fund ndodhi që Dhelpra Dinake u kap nga rojet me një gjel të madh ndër dhëmbë dhe me një duzinë vezësh, që i kishte pirë të freskëta e me gozhitat e tyre përpara këmbëve. Provat ishin të qarta, të sakta e të dokumentuara nga rojet dhe të dërguarit e posaçëm të gjykatësit të madh Luan Kapedani.

Erdhi dita e gjyqit; u parashtruan faktet, provat dhe gjithçka tjetër, sipas rregullave të vendosura më parë. Foli edhe avokati mbrojtës Arush Dudushi. Ai u përpoq të shfajësonte fajtoreshën dhe të përgënjeshtronte provat, t'u dredhonte fakteve, por si e pa që nuk i eci, kërkoi lehtësira për mëkatoren. Dhelpra Dinake rrinte kokulur, shpesh herë e vërente shtrembër avokatin e saj, si të ishte mjeran, duke menduar për paaftësinë e tij të madhe në mbrojtjen që po i bënte.

Me leje - foli ajo pastaj me gjysmë zëri. – Më falni, zoti gjykatës, që je edhe mbreti ynë suprem, më i madhi Sovran i Pyllit Dendak.

Lëri furçat, po fol çfarë ke? - gjëmoi zëri i Luan Kapedanit dhe të gjithë u ngjethën dhe mbajtën frymën pezull. – Po ta jap të drejtën e fjalës, sipas Ligjit. Mbrohu, në mundsh! ...

Më falni, - e ngriti zërin paksa skilja. – Mos më dënoni! Ju nuk duhet të më dënoni. Ka qenë e shkruar që unë të haja vezë të freskëta e të rrëmbeja ndër dhëmbë gjelin e madh teksa flinte. Ka qenë e shkruar. Dhe kur një gjë është e shkruar, s'ke çfarë bën... Kështu që unë jam pa faj. Pse të më dënoni, mua të shkretën?! Nuk duhet të ndëshkohem. Mua duhet të më falni, të më lironi...

Gjykatësit e tjerë u hutuan në fillim nga arsytimi i Dhelprës Dinake. Kujtuan se më këtë arsytim të mençur e humbën edhe këtë radhë davanë. Tundën kokat në shenjë miratimi dhe ulën sytë përdhe plot keqardhje dhe habi njëkohësisht.

Vetëm Gjel Lafshëmadhi turfulloi plot mllef, kërceu nga vendi ku rrinte, bëri disa herë "Kikiki e Kokoko", pastaj sikur u lodh, i ranë pendët dhe heshti.

Në çast Luan Kapedani kroji fuqishëm zërin, u ngrit me vendosmëri në këmbë dhe u bë gati të fliste. Të gjithë u tulatën përsëri. Dhelprës Dinake i ranë djersë të ftohta shtatit.

Meqë fole, moj skile, për sa thë, le ta zëmë të mirëqenë. Ç'është e shkruar, është e shkruar. Mirë. Paska qenë e shkruar që ti të bëje gjëmën në banesën e pulave e të gjelave. Po ti nuk e di se e shkruara nuk mbaron këtu, - buçiti zëri i Luan Kapedanit. – E thëna vazhdon, ajo ecën më tej. E shkruara e mëpastajme për ty thotë se do të dënohesh me burgim të përjetshëm. Fillimisht do të hash pas kurrizit 100 shkopinje thane e kështu me radhë çdo ditë. Torturat e tjera i kemi të shkruara në letër. Seanca gjyqësore mbyllet.

E shkruar, e mallkuar! - psherëtiu thellë Dhelpra Dinake. Pastaj mbylli sytë dhe vari kokën përmbi gjoks e mundur dhe e penduar thellë. Para se t'i binte të fikët ajo mendoi: "Nuk shpëtoka fajtori i fajshëm kur gjykatësit si Luan Kapedani janë të ndershëm, të mençur e trim! Mjera unë e mjera, ç'të shkruar të zezë paskam pasur!"

Përralla në shesh, e drejta mes nesh.





AUTORITETI I ISLAMIT, SIMBOLI I DASHURISË, MREKULLIA E KOHËS

Dorian Demetja

Në këtë libër është përfshirë kryesisht jeta dhe vepra e tre njerëzve të mëdhenj, të cilët kanë jetuar në shekujt XI – Ebu Hamid El-Gazali, XIII - Mevlana Xhelaledin Rumi dhe XX – Bediuzzaman Said Nursi. Këta dijetarë të fesë, punuan shumë për të dhënë interpretimet dhe mesazhet e duhura të Islamit në kohën kur kanë jetuar.